

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7551 E mërkurë 6 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "Deutsche Welle"
Gjermania është e revoltuar. Vetëm pak orë pas publikimit të një interviste të ambasadorit të SHBA-ve në Gjermani, Richard Grenell, janë shtuar zërat që ...
Vijon në faqen 21

Nga INES POHL
SHBA nxisin përçarjen e Evropës


Opinion Ditës
Dy partitë më të mëdha të opozitës janë kapluar nga makthi se mos etiketohen si armiq të hapjes së negociatave të Shqipërisë me BE. Herë publikisht dhe ...
Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI
Lamtumirë opozitë, shihemi në shtator



Mikel Shallari: Më premtuan 20 mijë euro

Vrasësi i Artan Cukut lidh pakt me shtetin: Rrëfej kush më pagoi për krimin

10 vite burg për autorin: Komisar Cuku e kishte arrestuar Bledar Jambellin për vrasje në Vlorë

INA ALLKANJARI

Rreth një vit pas ekzekutimit të komisarit në lirim, Artan Cuku, "Gazeta Shqiptare" ka mundur të sigurojë dosjen e plotë të vrasjes, ku tregohen motivet që e shtynë të pandehurin Mikel Shallari të merrte përsipër krimin ...
Në faqen 5

DREJTORESHA E SHERBIMIT SOCIAL NE BASHKI: FAZA E DYTE NIS PAS 15 KORRIKUT

KREDITE E BUTA, JA 2556 FITUESIT E FAZES SE PARE

Anisa Ruseti: Qytetarët kanë 1 muaj afat për t'u ankuar, më pas vijojmë me plotësimin e dokumentacionit për subvencionim të interesave të kredisë



(Në foto) Banesat sociale në Tiranë

Në faqen 17-20

ATENTATI

Plumb në kokë biznesmenit në Vlorë, dyshimet për hakmarrje

Në faqen 7

"VIP PAGES"

I ati lavdëroi Ramën, flet deputetja e PD, Fatbardha Kadiu: Si është e vërteta e videos

Suplement

PROCEDURAT

ALUIZNI: 320 personat që kanë gati lejet e legalizimeve, pronarët në qarkun e Lezhës

Në faqen 10

VENDIMET 1993-2008

Pronarët në Shkodër, ATP merr në shqyrtim 4400 dosje, procedurat për t'u njohur me ecurinë

Në faqen 11

KRYEMINISTRI INAUGURON PAJISJEN TEK ONKOLOGJIKU



Pacientët me kancer, në pritje të shërbimit prej dy javësh: Është prishur akseleratori

Në faqen 9

Kryeministri çel sezonin në Vlorë: Synojmë 10 milionë turistë në 5 vite

Rama: Aeroporti i Vlorës, para vitit 2020

Fatmir Xhafaj paralajmëron: Masa të rrepta për zhurmat dhe motorët e ujit

Kryeministri Edi Rama tha dje nga Vlorë se investimet në fushën e turizmit po rriten gjithnjë e më shumë. Duke folur në çelje të sezonit turizmit, Rama lajmëroi se do të nisë faza tjetër e investimeve për Lungomaren. Për sa u përket mjeteve lundruese, Rama tha se do të merren



masa duke i lejuar që të lundrojnë në hapësira të caktuara, ndërsa në të kundërt do të sekuestrohen. "Sivjet do kemi 15% më shumë se sa vjet, minimalja. Objektivi për të arritur 10 milionë turistë në Shqipëri në harkun e 5 viteve të ardhshëm ...

Në faqen 2

SEZONI TURISTIK NISJA

Kryeministri çel sezonin turistik në Vlorë: Së shpejti, faza e dytë e Lungomares

Kryeministri Edi Rama tha dje, nga Vlorë se investimet në fushën e turizmit po rriten gjithnjë e më shumë. Duke folur në çelje të sezonit turistik, Rama lajmëroi se do të nisë faza tjetër e investimeve për Lungomaren.

Për sa i përket mjeteve lundruese, Rama tha se do të merren masa duke i lejuar që të lundrojnë në hapësira të caktuara, ndërsa në të kundërt do të sekuestrohen. "Sivjet do kemi 15% më shumë se sa vjet, minimalja. Objektivi për të arritur 10 milionë turistë në Shqipëri në harkun e 5 viteve të ardhshëm është tërësisht i mundur", tha ai. "Fluksi i kërkesave për të investuar në turizëm është në rritje të ndjeshme. Patjetër që nuk e zgjodhëm kot Vlorën për këtë paraqitje, sepse Vlorë është një nga potencialet turistike dhe është embleme e ndryshimeve turistike që ka prekur vendin. Së shpejti nis faza tjetër e Lungomares, pjesa nga krahu jugor dhe po ashtu sjell një përmirësim të ndjeshëm ku ju e dini që ka shumë gjëra që qëndrojnë aty. Qendra historike ka një projekt të veçantë rrijetëzimi", u shpreh kryeministri.

"Në muajt në vijim do të fillojë puna për dy lotet e tjera të lumit të Vlorës, ku do të shikojmë një zhvillim intensiv, hap pas hapi të agroturizmit, pasi është një zonë me potencial të jashtëzakonshëm. Jemi duke negociuar për ndërtimin e aeroportit të Vlorës. Kam bindjen se ne do ta realizojmë aeroportin në një kohë më të shpejtë se sa parashikohet dhe uroj të realizohet, siç unë kam bindjen dhe shpresoj ta hapim pak përpara vitit 2020", u shpreh Rama. Nga Orikumi në çelje të sezonit turistik, ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj deklaroi se janë marrë të gjitha masat për mbarrëvajtjen, pasi është një periudhë shumë e ngjeshur. Ai theksoi 5 pika që synojnë më shumë rend dhe siguri për qytetarët shqiptarë dhe turistët që do të zgjedhin Shqipërinë për të pushuar. Shtimi i forcave të policisë, menaxhimi i trafikut rrugor, kontrolli i rreptë i motorëve të ujit, masat kundër zhurmave dhe përdorimit pa orar të muzikës, por edhe lehtësimi i hyrje-daljeve në kufi janë disa nga masat që do të jenë në vëmendjen e policisë.

VEPRIMTARIA E POLICISË

Policia e Shteti këtë sezon turistik do të jetë në gatishmëri për të garantuar një sezon turistik sa më të mirë,

Rama: 10 milionë turistë në 5 vite, aeroporti i Vlorës para vitit 2020

Xhafaj: Masa të rrepta për motorët e ujit



Kryeministri Edi Rama, dje në Vlorë

duke ofruar për pushuesit e huaj dhe ata vendas pushime të sigurt dhe më shumë rend.

Lajmi u bë i ditur nga min-

istri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj në hapjen e sezonit turistik të qytetit të Vlorës, duke theksuar disa nga masat që kjo ministri do të ndër-

FATMIR XHAFAJ

"Qindra edhe mijëra oficerë dhe punonjës të Policisë së Shtetit, edhe këtë verë nuk do t'u bashkohen familjeve të tyre, por do të shërbejnë shpesh me orë të zgjatura pune, edhe në kushte të vështira, nën diellin e nxehtë të verës. Duke u dhënë atyre gjithë mbështetjen dhe respektin tim si ministër, duke u kërkuar familjeve të tyre mirëkuptim për këtë sakrificë familjare, do të dëshiroja t'i kërkoja çdo qytetari mirëkuptim e respekt"

marrë për sezon të sigurt turistik. Ministri u ndalë të një nga problemet shqetësuese për pushuesit siç janë motorët e ujit të, për të cilat

Xhafaj bëri me dije se do të merren masa të rrepta, si për to por edhe për zhurmat e krijuara pas orarit të lejuar. "Kemi forcuar masat për një kontroll shumë të fortë ndaj motorëve të ujit, deri në sekuestrimin e tyre, duke marrë shkas nga viti i kaluar kur ka pasur edhe pushues që kanë humbur jetën. Do të ketë masa shumë më të forta lidhur me mjedisin në zonat turistike lidhur me zhurmat. Do të ketë edhe lehtësi të lëvizjes në pikat kufitare për shqiptarët, kosovarët, por edhe për turistët e huaj. Do të ketë një kontakt edhe me operatorët turistikë për të marrë masa për lehtësira. Nuk zgjidhet gjithçka me policisë, por secili duhet të bëjë detyrat e tij", tha Xhafaj nga Orikumi. Për të garantuar një sezon të qetë turistik, ministri Xhafaj bëri me dije se do të aktivizohen punonjës shtesë të policisë dhe do të ndërtohen nënstacionet provizore policie.



BASHKEPUNIMI

Bushati takon homologun japonez: Ka interes për investime në Shqipëri

Japonia ka rol të shtuar në rajon për mesazhin e Bashkëpunimit me Ballkanin Perëndimor dhe do ndihmojë rajonin në rrugë drejt anëtarësimit në BE, ka deklaruar Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati gjatë takimit dje, me ministrin për Punët e Jashtë të Japonisë, Taro Kono. "Jam i lumtur të konstatoj rritje të interesit të kompanive japoneze për të investuar në Shqipëri - nënvizoi ministri Kono. Kjo do të kontribuojë edhe në zhvillim lokal të vendit. Japonia është e gatshme të ndihmojë të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre të reformave drejt anëtarësimit në BE, edhe në kuadër të Nismës së Ballkanit Perëndimor të lançuar nga Kryeministri japonez në fillim të këtij viti, gjatë turit të tij në Europën Juglindore dhe Ballkan". Ministri Bushati falenderoi qeverinë japoneze për bashkëpunimin e deritanishëm, si një nga mbështetësit më të rëndësishëm të vendit në 27 vitet e fundit nëpërmjet projekteve konkrete për zhvillimin e reformave shtet-ndërtuese dhe ekonomike. Ministri Bushati zhvilloi, gjithashtu, një takim në parlamentin e Japonisë.

Ministria e Drejtësisë merr Kodhelin e deputeten e PD në Gjermani

Gjonaj, seancë në parlamentin gjerman: Reformat, perspektiva europiane e vendit



e para të prekshme të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe me mbështetjen e qeverisë shqiptare për ngritjen e organeve të reja të sistemit të drejtësisë", u shpreh dje, ministria Gjonaj, pas takimeve. Ajo iu përgjigj interesit të ligjvënësve gjermanë duke theksuar se "procesi i

vetingut po ecën me një ritëm të kënaqshëm dhe është parashikuar që shumë shpejt do të përfundojë rivlerësimi i listës prioritare dhe më pas menjëherë mund të ngrihen organet e reja të sistemit të drejtësisë. Ndërkohë që reformat e tjera që po ndërmerr Shqipëria për çështjen e pronave, përmirësimin e shërbimeve publike dhe derregullimin garantojnë forcimin e shtetit të drejtë dhe rrugëtimin evropian të Shqipërisë". Po ashtu ajo prezantoi masat që qeveria shqiptare ka marrë për të forcuar luftën kundër kultivimit të kanabisit, duke vënë në dukje që për herë të parë Shqipëria ka dalë nga

harta e vendeve kultivuese të kanabisit. Në funksion të luftës kundër krimit të organizuar transnacional Shqipëria ka miratuar në parim marrëveshjen me Eurojust, e cila i lejon autoritetet shqiptare që në bashkëpunim me autoritetet e tjera të vendeve të BE të kryejnë hetime të përbashkëta. "Reformat që po ndërmerrim, më shumë se sa një detyrë shtëpie në kuadër të integritimit në BE, janë perspektiva europiane që ne duam t'i ofrojmë qytetarëve Shqiptarë. Ne duam që qytetarët shqiptarë ta gjejnë Evropën në Shqipëri", u shpreh Gjonaj.



Dibër, presidenti mbledh bashkë ministra e deputetë të PS e PD

Meta: Të forcojmë rrënjët tona, solidaritetet për të bërë më shumë

Majko e Nikolla shoqëruan kreun e shtetit në Sllovë

Darina Tanushi

Presidenti i Republikës, Ilir Meta mbledhi dje, në Sllovë të Dibrës ministra e deputetë të PS-së dhe ata të PD-së. Ai mori pjesë dje, në ceremoninë e përirimit të rikonstruksionit të Shkollës së Mesme të Bashkuar "Ajet Ndreu" në Sllovë, të ringritur me fondet private të pinjollit të familjes Ndreu, Shpend Ndreu. Në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve, Presidenti i Republikës u shpreh: "Ju falënderoj për këtë solidaritet, për këtë bashkëpunim e gjithëpërfshirje! Këtu i kemi të gjithë dhe kjo tregon se të gjithë e duan Dibrën, e duan Shqipërinë, dhe aq më tepër se jemi në Vitin Mbarëkombëtar të Gjergj Kastrioti Skënderbeut, pa hapur debat me Krujën, le ta bëjmë të gjithë së bashku e këtë do ta bëjmë duke bërë më shumë për arsimimin e për edukimin e fëmijëve tanë! Jo vetëm me dijet më bashkëkohore dhe më të avancuara, por në radhë të parë për t'i edukuar me dashurinë për vendlindjen, për familjen dhe Atdheun!" Presidenti falënderoi nënën e Shpend Ndreut, i cili ka kontribuar për këtë shkollë, duke i thënë se "ka rritur dhe edukuar një bir të denjë të kësaj zone e të gjithë Dibrës, i cili është një shembull jo vetëm për të gjithë djemtë e aftë, të zotë e atdhetarë të Dibrës kudo ku janë, por për të gjithë shqiptarët e zotë e të aftë, që të ndihmojnë vendlindjen e tyre". "Mesazhi im është të forcojmë rrënjët tona. Të forcojmë ndjenjat e atdhe-dashurisë! Nëse nuk duam vendlindjen, nuk duam të parët tanë, në qoftë se nuk ruajmë traditat tona, në këtë botë kaq të madhe, e nganjëherë kaq kaotike, në mund të jemi asgjë. Prandaj që të vazhdojmë të jemi shqiptarë të të jemi krenarë për atë që kanë bërë të parët tanë, të bëjmë më shumë për vendin tonë, në mënyrë që edhe këta fëmijë të jenë akoma edhe më krenarë në të ardhmen për përkatësinë e tyre, edhe si dibranë, edhe si shqiptarë", u shpreh kreu i shtetit. "Të gjithë s' duhet të përulemi me shumë nderim para Shpendit për këtë punë e vepër që ka bërë, sepse



Presidenti i Republikës, Ilir Meta, dje në Sllovë të Dibrës me ministrat e deputetë të PS-së dhe të PD-së

DRONI

Kryeministri Edi Rama u prit dje në Vlorë, ku bëri çeljen e sezonit turistik dhe prezantoi strategjinë për turizmin nga një dron, i cili mbante një pankartë. Kjo ishte organizuar nga të rinjtë e Forumit Rinor të Partisë Demokratike dhe mbi të shkruhej: "Mjaft i zgjedhi mafia dhe droga ministrat, ta zgjedhi edhe një popull!".

Municipionet e paplasura, Xhaçka: Brenda 2019, asnjë zonë e rrezikshme në Shqipëri

Për më shumë se 20 vite, hotspoti i Suçit në Burrel ka qenë një prej pikave më të rrezikshme për shkak të municioneve të paplasura. Efektivët e Kompanisë së Asgjësimit të Municioneve (EOD- Explosive Ordnance Disposal) të Komandës Mbështetëse në Forcat e Armatosura, për më shumë se 1 muaj bënë të mundur pastrimin e plotë të zonës. Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka gjatë takimit me efektivët e EOD në terren, deklaroi se tashmë i kthehen komunitetit 84 mijë metra katrorë të certifikuar, të pastër dhe të sigurt. "Janë rreth 84 mijë metra katrorë që i kthehen komunitetit që tanimë janë të certifikuar, të pastra dhe të sigurt. Efektivët tanë kanë rreth 1 muaj që punojnë këtu. Ka qenë një zonë goxha e pasigurt dhe paraqiste rrezikshmëri të lartë për shkak të municioneve të paplasura qysh prej vitit 97", u shpreh ministria Xhaçka. "Bashkë me hot spotin e Selicës që gjykojmë që ndoshta pas 5 muajve do ta mbarojmë edhe atë, i kemi kthyer komunitetit gjatë gjithë kësaj periudhe 17 hot spot, mijëra metra katrorë të pastruar dhe të sigurt për përdorim civil. Dhe për vitin 2019, ambicia jonë është që të përfundojmë edhe 2 hot spotet e fundit për t'i kthyer edhe ato komunitetit, duke i certifikuar të pastra dhe të sigurt", u shpreh Ministria. Ministria e Mbrojtjes vlerësoi efektivët e FA, për punën e jashtëzakonshme në këtë mision kaq të rëndësishëm dhe për ndihmën që po i japin komunitetit në këto zona.

Vasili: LSI kundër PS që kryeprokuroria e KLD të firmosin emërimet në drejtësi

Lëvizja Socialiste për Integrim jo vetëm që nuk do të japë votën për nismën e Partisë Socialiste për ndryshimin në statusin e gjyqtarit dhe prokurorit, por ka hedhur akuzën në drejtësi të mazhorancës që sipas kreut të Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, me të gjitha format po vë nën kontroll sistemin e drejtësisë. Sipas Vasilit, PS po kërkon që Arta Marku ta kthejë në një prokuror të përjetshme. "Përveçse do të përdorë në mënyrë të turpshme Këshillin e Lartë të Drejtësisë, për të cilin kishte ato përcaktime që ju dëgjua, njëherazi do që Prokuroren e Përgjithshme të përkohshme zni., Arta Marku ta legjitimojë përfundimisht si një Prokuror të Përgjithshme të përjetshme", u shpreh Vasili. Sipas tij, shumica po përdor instrumentet e vjetër për të reformuar drejtësinë, duke iu referuar KLD-së. "Sigurisht LSI nuk do të jetë dhe nuk mund të jetë kurrë pjesë e konsensusit të tillë të kalburës, të cilat zhbejnë reformat dhe godasin Kushtetutën e vendit". Nisma e PS-së parashikon që të rikthejë për dy vitet e ardhshme emërimet në drejtësi nga KLD dhe Prokurori i Përgjithshëm.

Ambasadori italian nga Shkodra: Në Itali nuk ka asnjë proces ndaj Tahirit

Cutillo: Vëllai i Xhafajt do të rrijë në burg më pak se dënimi

Ambasadori italian, Alberto Cutillo deklaroi dje nga qyteti i Shkodrës se në Itali nuk ka asnjë hetim kundër ish-ministrit Saimir Tahiri. Cutillo iu përgjigj gazetarëve, pas aktivitetit të organizuar me rastin e Festës së Republikës së Italisë. "Unë e di që në Itali ka një proces, por jo kundër Tahirit, por unë di po aq sa dini ju", u shpreh ambasadori Cutillo. Dy javë më parë Gjykata e Apelit për Krime të Rënda shfuqizoi masën e sigurisë "Arrest shtëpie" për ish-ministrit e Brendshëm, Saimir Tahiri, vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë. Sipas vendimit të kësaj gjykate, Tahiri do të vijojë të jetë në hetim pa masë sigurie. Ndërkohë, në një sqarim për TV "Klan", ambasadori italian tha dje se vëllai i ministrit Fatmir Xhafaj nuk do të vuajë të gjithë dënimin e marrë. "Personi është dorëzuar vullnetarisht në Policinë Kufitare të Fiumicino dhe është transferuar në burgun e Civitavecchia pranë Ro-



mës, ku do të vuajë dënimin. Pak a shumë dënimi ishte 4 vjet e dy muaj. Pasi vuajti një muaj, në kohën kur u arrestua mbeten edhe 4 vjet e 28 ditë. Në të tilla raste, nëse i burgosuri bën kërkesë, mund të lirohet shumë më herët se kjo datë. Nuk e di si do të zhvillohet çështja, por me shumë mundësi periudha që duhet të kalojë në burgim do të jetë shumë më e shkurtër", ka sqaruar ambasadori. Diplomati italian sqaron edhe përse nga shteti italian nuk pati kërkesë për ekstradim për Agron Xhafaj. "Personi është dënuar në Itali, por sipas rregullave të brendshme ital-

iane, kur dënimi nuk kalon një masë të caktuar nuk kërkohet ekstradim, sepse impenjimi për këtë kërkesë është shumë më i madh se mundësia që të vuhet një dënim kaq i shkurtër. Kemi mijëra raste të tilla dhe ky nuk është një përjashtim. Dënimet më pak se 3 vjet nuk vuhet në burg nëse nuk ka përsëritje të krim-it. Ndërsa për ato mbi 4 vjet shkohet në shërbime sociale, gjithsesi nuk shkohet në burg. Dënimet që nuk e kalojnë këtë masë nuk konsiderohen mjaftueshëm të rënda për të justifikuar procedurën e ekstradimit", u shpreh Cutillo. Agron Xhafaj u dorëzua në Itali më 16 maj, pak ditë pasi opozita publikoi dosjen e tij me dënimin për trafik droge dhe një audiopërgjim, që sipas saj, e implikonte atë në një tjetër rast të trafikut të drogës kohë e fundit në Shqipëri. Opozita akuzoi ministrin e Brendshëm se i ka ofruar mbrojtje të vjetër dhe kërkoi dorëheqjen e tij, por këto akuzat u hodhën poshtë nga Xhafaj dhe mazhoranca.

Nënë Tereza me shumë të drejtë ka thënë që ndoshta ndonjë gjë të madhe mund të mos bëjmë në këtë botë, por secili prej nesh një gjë të vogël, me dashuri të madhe, mund ta bëjë", tha më tej, Presidenti. "Unë besoj se ky është një mesazh shumë i fuqishëm që shkon përtej Dibrës e kudo tjetër ku ka shqiptarë, të cilët e duan vendin e tyre, traditat e tyre e të cilët janë krenarë për

paraardhësit e tyre", u shpreh Meta. Presidenti Meta i shoqëruar nga deputetët e qarkut, ministri Pandeli Majko dhe Lindita Nikolla, Kryetari i Bashkisë Dibrë, Muharrem Rama dhe përfaqësuesit e pushtetit vendor, vizitoi ambientet e rikonstruktura të Shkollës së Mesme të Bashkuar të Sllovës ku theksoi rëndësinë e shkollimit dhe arsimit të brezit të ri, për të cilin dibranët dhe di-

aspura kanë investuar shumë e janë përpjekur pamasë përgjatë gjithë rrjedhës së historisë. Në përfundim të vizitës Presidenti i Republikës vendosi kurora me lule në memorialin e ngritur në nderim me mirënjohje për patriotët e zonës Elez Isufi, Isuf Xhelili dhe Cen Elezi dhe u përul me respekt para vepërës dhe kontributit të tyre të paharuar atdhetar në mbrojtje të trojeve shqiptare.

ÇËSHTJA "XHAFAJ" AKUZAT

Ish-kryeministri tregon çfarë do të ndodhë me negociatat: Edvini bën dudumin

Berisha nxjerr mesazhin e presidentit të PPE: Kërkoj largimin e Xhafajt

"Ikja e kryeministrit, rruga drejt BE-së"

Valentina Madani

Presidenti i Partisë Popullore Europiane, Joseph Daul ka kërkuar largimin e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Këtë informacion e publikoi dje ish-kryeministri Sali Berisha në rrjetet sociale, teksa postoi edhe citimin e Daul. "Gjatë mbledhjes së Asamblesë Politike të PPE në Varshavë, presidenti Jozeph Dual ndër të tjera, është shprehur: "Ne po e ndjekim nga shumë afër qeverinë shqiptare, për shkak të përfshirjes së ministrit të Punëve të Brendshme në trafikun e drogës dhe krimin e organizuar. Nëse nuk përmbushen principet e zbatimit të ligjit, unë nuk shoh se si mund të ketë një përgjigje pozitive për hapjen e negociatave me Shqipërinë. Ndaj ne duhet të shohim nëse do të ketë ndryshime deri në samitin e ardhshëm", shprehet z.Berisha, teksa citon presidentin e PPE, Berisha akuzon se "Xhafaj i drogës është bllokues i hapjes së negociatave!". "Pra, Fatziu i drogës po mban peng hapjen e negociatave të Shqipërisë me BE! Kjo faktori edhe një here se Edvin Krista Rama, midis Europës dhe drogës ka zgjedhur drogën dhe paratë e saj të krimi! Largimi tij nga pushteti është rruga e vetme për të ecur drejt BBE", shprehet z.Berisha.

TAKIMI

Ish-kryeministri Sali Berisha komentoi dje deklaratat e bëra nga kryeministri bullgar, Borisov gjatë takimit me shefin e qeverisë për hapjen e negociatave për anëtarësim të Shqipërisë në BE. Berisha shprehet se përveç faktit që dy-tri vende të BE janë kundër hapjes së negociatave, shumica e vendeve anëtare janë për hapjen me kushte të negociatave me Shqipërinë. Sipas tij, ky është një qëndrim identik me ata që u mbajt ndaj Shqipërisë në vitin 2016, vit në të cilin, përveç kushteve të vendeve anëtare për hapjen e negociatave, si data



Ish-kryeministri Sali Berisha

DEBATI

Mbledhja e Komisionit Ekonomisë e Financave u shoqërua sërish dje me debate mes mazhorancës dhe opozitës për çështjen "Xhafaj". Demokratët kërkuar dorëheqjen e ministrit të Brendshëm në vijim të akuzave në adresë të të vëllait. Ndërsa kreu i komisionit, Braçe e konsideroi akt të pastër kriminal audio-përgjimin e PD-së përmes një personazhi të njohur tashmë si "Babalja".

"Merrni valixhet e biletën pa kthim"

Të rinjtë e FRPD dhe LRI protestojnë poshtë zyrës së Xhafajt

Forumi Rinor i PD-së dhe LRI-së protestuan sërish dje kundër ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Një grup të rinjsh u mbledhën poshtë zyrës së Xhafajt, ndërsa kërkuar largimin e këtij të fundit nga detyra. Kreu i FRPD-së, Belind Këllçi nuk kursye sulmet për qeverinë "Rama". "Të çojmë Ramën, Xhafajn e Tahirin me shpurën e rilindjes në emigrim e të rrimë 2 milionë shqiptarë në vendin tonë. Dy ministra të Brendshëm të Edi Ramës janë faktuar si bashkpunëtorë të trafikantëve të drogës. Ky është realiteti i Shqipërisë me Edi Ramën. Kjo është e vërteta që fasado-qeveria



kërkon ta fshehtë me ndihmën e parave të drogës dhe krimi. Shqipëria është kthyer në diktaturë, drejtësia ka vdekur, rendi është në duar

për hapjen e tyre u përmendën si më të largëtat gjysma e dytë e vitit 2017 ose gjysma e parë e vitit 2018. Por, Berisha shprehet se përballë këtyre deklaratave, Rama bëri sikur nuk kuptoi. "Ky është një qëndrim identik me

atë që u mbajt ndaj Shqipërisë në vitin 2016, vit në të cilin, përveç kushteve të vendeve anëtare për hapjen e negociatave, data për hapjen e tyre u përmendën si më të largëtat, gjysma e dytë e vitit 2017, ose gjysma e parë e vitit

të krimi, kryetari i opozitës survejohet nga policia dhe narko-kryeministri na shet përralla me punësim dhe zhvillim. Po nuk reaguam sot, nëse narko-kryeministri nuk do të na mohojë veç fjalën, por do të na kërcënojë edhe jetën. O sot, o kurrë të shpërrim narko-kryeministrin, që rri si korb mbi kokat e shqiptarëve. Të çojmë në emigrim Ramën, Xhafajn, Tahirin, Dakon, Ruçin, Ballën, Sejdimin, Veliain, Begjan, Termet Peçin, Artur Bushin, Ahmetajn, Gjinkurin, Nikollën që të qëndrojnë 2 milionë shqiptarë këtu, që rinia të jetojë ëe Shqipërinë europiane", tha Këllçi.

2018. Në fakt, të dy këto afate kaluan dhe negociatat nuk u hapën për faktin e thjeshtë se jo që nuk janë plotësuar; por janë përkeqësuar ndjeshëm kushtet e kërkuara nga vendet anëtare të BE", tha z.Berisha.



Presidenti i Partisë Popullore Europiane, Joseph Daul

AKUZA



Paloka: Drejtësia, në kolaps prej avokatëve të Ramës

Nënkryetari i PD-së, Edi Paloka deklaroi dje se drejtësia është në kolaps, ndërsa sulmoi edhe Vasilika Hysin, duke e cilësuar atë si avokat të Ramës. Ai përmendi se edhe në diktaturë, gjykatat funksiononin qoftë edhe formalisht. "Drejtësia në kolaps. Del në skenë prapë avokatja e kauzave të dëshpëruara: Nuk ka asnjë problem që vendi është pa Gjykatë Kushtetuese, madje nuk ka problem po mbeti edhe pa Gjykatë të Lartë... Rama përdor dy 'avokate' për çështjet e pambrojtshme. Të parin përdor Ballën, që ka pafytyrësinë si tipar dallues dhe kur çështja është aq e rëndë sa as i pafytyri nuk e merr përsipër, nxjerr 'juristen' që e ka vënë nënkryetare Parlamentit vetëm që ta përdorë kur i duhet. E vënë përballë një gazetareje mbremë, përfaqësuesja e Ramës bëri të paktën dy deklaratat skandalozë me qetësi absolute. E pyetur për mosfunksionimin e Gjykatës Kushtetuese dhe rrezikun që kjo situatë të verifikohet dhe me Gjykatën e Lartë, avokatja e Ramës u përgjigj me qetësi se asnjë problem nuk krijohet", tha Paloka.

KRIZA



Tabaku: Euro në pikiatë, krimi mban në këmbë qeverinë

Nënkryetaria e Komisionit të Ekonomisë, Jorida Tabaku, theksoi se në sektorin e ndërtimit dhe turizmit po ndodh një situatë e çuditshme investimesh, e cila sipas saj, nuk po justifikohet as nga Banka e Shqipërisë, as nga INSTAT dhe as nga shifrat e publikuara nga të gjitha institucionet e tjera ndërkombëtare. "Citot raportin e DASH, që thotë se qeveria duhet të konsiderojë kabanë alarmi që sektorë si ndërtimi dhe turizmi janë duke pastruar paratë", tha Tabaku. Duke analizuar shkaktarët e rënies së vlerës së euros, ajo theksoi se qeveria duhet të marrë përgjegjësi për këtë çështje dhe të zgjidhë urgjent situatën. Duke iu referuar ekonomisë së Shqipërisë, Tabaku iu drejtua mazhorancës në komision me pyetjen se, "Përse 5 mijë e 800 biznese janë mbyllur vetëm 5 muajt e parë të vitit?". "Përgjigja e këtyre pyetjeve është paraja e drogës, si garancia e vetme e qeverisë për të mbajtur në këmbë krimin", tha Tabaku.

Dosja e plotë, 25-vjeçari Mikel Shallari: Më premtuan 20 mijë euro

Vrasësi i Artan Cukut lidh pakt me shtetin: Rrëfej kush më pagoi për krimin


10 vite burg për autorin: Komisar Cuku e kishte arrestuar Bledar Jambellin për vrasje në Vlorë

Ina Allkanjari

Reth një vit pas ekzekutimit të komisarit në lirim, Artan Cuku, "Gazeta Shqiptare" ka mundur të sigurojë dosjen e plotë të vrasjes, ku tregohen motivet që e shtynë të pandehurit Mikel Shallarin të merrte përsipër krimin. Në dosje përshkruhet me detaje se si u identifikua Mikel Shallari falë gjurmëve të ADN-së dhe detajet e dhëna prej tij përpara grupit hetimor. Kujtojmë se më datë 12.06.2017 u nënshkrua marrëveshja dhe bashkëpunimit me drejtësinë, falë së cilës Shallari fitoi statusin e "bashkëpunëtorit të drejtësisë". 25-vjeçari tregoi me detaje krimin dhe emrat e bashkëpunëtorëve. Siç thuhet edhe në dosje, organizatori dhe porositësi i vrasjes është Bledar Jambelli (Rikardo Muho) i arrestuar tashmë dhe bashkëpunëtorit është Gerti Kaji (Kristaq Leci), ky i fundit, djali i dajës së të pandehurit. Ndërkohë, ditën e djeshme Gjykata e Krimeve të Rënda ka pranuar kërkesën e prokurorit Henrik Ligori për ligjërimin e aktmarrëveshjes për të dënuar me 10 vite burg Mikel Shallarin.

KRONOLOGJIA E KRIMIT

Më datë 8.04.2017, rreth orës 20.10, në hyrjen e pallatit "Melrose", që ndodhet në kryqëzimin e Rrugës së Kosovës me rrugën "Ndreko Rino", në Tiranë, u vra me armë zjarri viktimja Artan Cuku, oficer në lirim i Policisë së Shtetit. Nga hetimet e para të kryera menjëherë pas vendngjarjes, duke studiuar filmimet spontane të kamerave të sigurisë së disa subjekteve private, u bë i mundur përcaktimi i itinerarit të largimit të autorit nga vendngjarja deri në afërsi të sheshit "Wilson". Mësohet se në atë pikë gjurmët humbnin dhe për hetuesit ishte i paqartë itinerari i largimit të mëtejshëm të tij nga vendngjarja. "Akti i ekspertimit mjekoligjor të kufomës së viktimës Artan Cuku konfirmoi se në trupin e tij u konstatuan 4 plagë të shkakut nga arma që vra me armë zjarri. Autori e priti viktimën i pozicionuar tek shkallët përballë derës së hyrjes. Pas goditjeve të para, viktimja ka tentuar të shpëtojë duke hyrë në ashensor, por ai u ndoq nga autori dhe u qëllua teksa ndodhej brenda tij. Goditjen fatale në kokë viktimja e mori pasi ridoli nga ashensori, duke tentuar të përleshet me autorin", thuhet në dosjen e prokurorisë. Më tej bëhet me dije se pas kryerjes së krimin, autori i dyshuar hoqi pjesën e sipërme dhe të poshtme të veshjes sportive dhe i hodhi në një kazan plehrash, i cili ndodhej në cepin e rrugës "Zef Jubani". Rrobrot u gjetën dhe u sekuestruan, si dhe u nënshtruan eksperimenteve teknike. I dyshuari u



AKUZA
Në përfundim të hetimeve, Mikel Shallari u akuzua se në rolin e ekzekutorit material, kundrejt pagesës dhe përfitimeve të tjera të premtuara nga organizatori Bledar Jambelli dhe ndërmjetësi Kristaq Leci, në bashkëpunim me këta të fundit ka vrarë për shkak të detyrës oficerin në lirim të Policisë së Shtetit, viktimën Artan Cuku.

TENTATIVA E PARË
Një tentativë u synua të kryhej pasditen e datës 7.04.2017, ku roli e ekzekutorit e pati marrë përsipër djali i dajës së tij, Kristaq Leci. Të dy u pozicionuan tek hapësira me bar përbri parkimit, përballë godinës së një universiteti privat, ku mbanin të fshehura dhe armët. E identifikuan viktimën, i cili u ul tek një kafe aty pranë. I pandehur Leci me një armë në brez e ndoqi nga pas, por nuk e kreu aktin nga frika e identifikimit.

fiksua të largohej duke mbajtur duart në xhepat e pjesës së sipërme të buzës sportive me zinxhir, me ngjyrë blu dhe bojëqelë. Pikërisht nisur nga gjurmët biologjike të lëna në xhepat e saj u arrit të ndërtohej profili gjenetik i ADN-së së një personi mashkull. "Profilin gjenetik i ADN-së së personit mashkull, i përfutur nga akti i ekspertimit biologjik u shpërnda nga ZK Interpol Tirana në zyrat homologe evropiane për të bërë krahasimin me të dhënat e bankave të tyre të ADN-së të personave të skeduar me precedentë penalë. Interpol Berna (Zvicër) konfirmoi se ky profil gjenetik ADN-je përputhej me atë të një personi të regjistruar në Zvicër me të dhënat: Mikel Shallari, lindur më 6. 11.1993 në Skrapar. Në këto rrethana, si i dyshuar në rolin e ekzekutorit të krimin u identifikua Mikel Shallari dhe prokuroria ur-

dhëroi vëzhgimin e tij në vende publike. Më datë 10.06.2017 u urdhërua ndalimi i tij i menjëhershëm, si person i dyshuar për vrasjen e Artan Cukut, në rolin e ekzekutorit material të krimin. Urdhri i ndalimit u ekzekutua në orën 23:10 të së njëjtës date. Ndërsa më datë 13.06.2017 gjykata e shkallës së parë për Krime të Rënda, Tiranë caktoi ndaj tij masën e sigurisë "Arrest me burg". Por akti kriminal i të arrestuarit Mikel Shallari nuk mbështetej nga ndonjë motiv, për këtë arsye u dyshua se pas tij mund të qëndronin persona të tjerë, në rolin e organizatorit dhe shtytësit", thuhet në dosjen e prokurorisë. Ndërkohë, bëhet me dije se Mikel Shallari u mor në pyetje nga organi i akuzës. Ai fillimisht e mohoi përshirjen e tij në krim. Më datë 12.06.2017, Shallari shprehu vullnetin për të bashkëpunu-

ar me drejtësinë dhe nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit me prokurorin. Mësohet se gjatë marrjes në pyetje ai dha deklarime të hollësishme lidhur me krimin e kryer prej tij dhe bashkëpunëtorit të tij, në rolin e organizatorit, të cilët i identifikoi përkatësisht si Bledar Jambelli dhe Kristaq Leci (Genti Kajo). Përsa u përket rrethanave dhe motivit të ngjarjes, Shallari dha shpjegime të hollësishme përpara grupit hetimor. Ai pranoi se për kryerjen e krimin ishin premtuar 20.000 euro nga personi i interesuar, të cilin ai e pati njohur me ndërmjetësimin e djalit të dajës së tij, të pandehurit Kristaq Leci (Genti Kajo), i cili e konsideronte atë person të rëndësishëm dhe e quante "i madhi" ose "Shefi". Ky person u identifikua më pas prej tij si Bledar Jambelli. Përveç çmimit të mësipërm

MOTIVI
I pandehur Mikel Shallari pranoi para grupit hetimor se për kryerjen e krimin i ishin premtuar 20.000 euro nga personi i interesuar, të cilin ai e pati njohur me ndërmjetësimin e djalit të dajës së tij, të pandehurit Kristaq Leci (Genti Kajo), i cili e konsideronte atë person të rëndësishëm dhe e quante "i madhi" ose "Shefi". Ky person u identifikua më pas prej tij si Bledar Jambelli.

lokal, ku organizatori me tone fyese shprehu pakënaqësinë ndaj tyre dhe i nxiti që krimin ta kryenin të nesërmen. I vë në përballë presionit dhe i detyruar për shkak të faktit se kishte pranuar pra nga Jambelli, i pandehuri Shallari mori përsipër ta kryente ai ekzekutimin. "I pandehuri ishte orientuar që të ndërtonte numrat telefonikë një herë në dy ditë. Shallari komunikonte vetëm me të pandehurin Leci, me Bledar Jambellin nuk ka komunikuar asnjëherë dhe nuk i dinte numrat telefonikë që ai përdorte. Ditën e ngjarjes, më 8.04.2017 ndërsa viktimja po kthehej në banesë, i pandehuri Shallari po e priste para pallatit. Në vendngjarje ai shoqërohej nga i pandehuri Kristaq Leci, i cili e priste tek fusha me bar aty pranë dhe e orientonte në distancë me anën e SMS-ve. Pasi viktimja u shfaq dhe u fut në një minimarket pranë hyrjes së pallatit, i pandehuri u pozicionua tek shkallët në pjesën e brendshme të hyrjes dhe me t'u shfaqur viktimja, e qëlloi me të dyja armët njëherësh. Viktimja mbijetoi dhe tentoi të hynte në ashensor, por i pandehuri iu vu pas dhe e qëlloi edhe aty. Më pas provohet se viktimja doli nga ashensori duke tentuar të përleshë fizikisht me autorin, por i pandehuri e qëlloi përsëri duke u dhënë goditjen fatale në pjesën e kokës", thuhet më tej në dosjen e prokurorisë. Sakaq, përpara grupit hetimor i pandehuri Shallari shpjegoi edhe motivin e krimin. Ai mësoi nga Bledar Jambelli dhe bashkëpunëtorit i tij, Kristaq Leci, se viktimja e pati arrestuar Jambellin, si të dyshuar për vrasjen e shtetasit Amarildo Delaj. Ky fakt provohet se ka ndodhur në kohën kur viktimja kryente detyrën e drejtorit të Policisë Vlorë. Jambelli, arrestimin e tij e quante të padrejtë, të nxitur nga persona të tjerë dhe ky ishte motivi që ai kishte vendosur që ta vraste viktimën Artan Cukun, duke u shprehur me fjalë fyese për të. Në përfundim të hetimeve, Mikel Shallari u akuzua se në rolin e ekzekutorit material, kundrejt një pagese prej 20.000 eurosh dhe përfitimeve të tjera të premtuara nga organizatori Bledar Jambelli dhe ndërmjetësi Kristaq Leci, në bashkëpunim me këta të fundit, ka vrarë për shkak të detyrës oficerin në lirim të Policisë së Shtetit, viktimën Artan Cuku.

Trupa gjyquese shpall vendimin në datën 7 qershor. Ja pasuria që ka deklaruar

Vetingu, prokurori i dosjes "Tahiri", Dritan Prençi drejt konfirmimit

KPK: Nuk ka shkelje dhe fshehje të pasurisë

Ina Allkanjari

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka zhvilluar ditën e djeshme seancën dëgjimore me prokurorin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, Dritan Prençi. Ai u njoh me rezultatet e hetimit administrativ të komisionit. Sipas Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë, pasuria e Prençit është e justifikuar. Trupa e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit e përbërë nga Genta Tafa Bungo, Pamela Qirko dhe Suela Zhegu u shprehën se nga verifikimi i ILDKPKI dhe i vetë komisionit ka rezultuar se gjyqtarja nuk ka shkelje dhe fshehje të pasurisë. Kujtojmë se Dritan Prençi është pjesë e hetuesve të dosjes së ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. KPK lexoi raportin ku thuhet se Prençi ka një apartament 71,4 metra katrorë të blerë në vitin 2008 me vlerë 31,200 euro dhe të likuiduar me kredi, 936 mijë lekë të kredisë janë ende pashlyera. Prençi ka deklaruar në pronësi edhe një automjet që e ka blerë për 2,000 euro. Këto janë pasuritë e paluajtshme të prokurorit Dritan Prençi. Ai ka deklaruar edhe një kredi tjetër me interes 3 për qind, në shumën 2,596,000 euro me një afat prej 96 muajsh. "Jam para një procesi transparent dhe jam dakord me gjetjet e komisionit. Kërkoj konfirmimin në detyrë", - ka thënë Dritan Prençi në seancën e KPK-së, ndërsa vendimi nga KPK pritet të merret në datën 7 qershor. Në adresë të prokurorit ka pasur një kallëzim në Prokurorinë e



Prokurori i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda të Tiranës, Dritan Prençi

Kurbinit për shpërdorim detyre, por është vendosur mosfillim, pasi s'ka pasur vepra penale. Konkretisht, shtetasi H.P. ka kallëzuar për shkelje të etikes së prokurorit, pasi sipas këtij, shtetasi Dritan Prençi ka nxjerrë nga zyra avokatin e tij. Sipas KPK-së, Prençi rezultoi në të tria shtyllat e kualifikimit.

PASURIA

Por të dhënat e analizuara nga BIRN tregojnë se prokurori Dritan Prençi nuk zotëronte asnjë pasuri në vitin 2003-kur e ka deklaruar atë për herë të parë. Në fund të vitit 2016, pasuria familjare e prokurorit Dritan Prençi kap vlerën e 4.59 milionë lekëve. Diferencën në rritjen e pasurisë së zotit Prençi e bën blerja e një apartamenti me kredi në vlerën e 4.3 milionë lekëve, pasuria e vetme e paluajtshme që ai zotëron. Gjithashtu, në fund të vitit 2016 prokurori ka deklaruar se zotëron likuiditete në bankë në vlerën e 9444 lekëve dhe një automjet të blerë për rreth 277 mijë lekë. Të

ardhurat e familjes Prençi përbëhen vetëm nga paga e tij dhe ajo e bashkëshortes.

Përgjatë 13 viteve të deklarimit, të ardhurat familjare të prokurorit Prençi kapin

RAPORTI

KPK lexoi raportin, ku thuhet se Prençi ka një apartament 71,4 metra katrorë të blerë në vitin 2008 me vlerë 31,200 euro dhe të likuiduar me kredi, 936 mijë lekë të kredisë janë ende pashlyera. Prençi ka deklaruar në pronësi edhe një automjet që e ka blerë për 2,000 euro.

strukturën e aseteve dhe të ardhurave, ky raport paraqet dhe kontrollin aritmetik/logjik të deklaramëve të subjektit si dhe "flamujt e kuq", që identifikohen gjatë kontrollit. Në rastin e zotit Prençi iu nënshtruan kontrollit aritmetik-logjik 12 deklarata pasurie dhe asnjëra prej tyre nuk rezultoi me probleme. Duke qenë se ky raport bazohet në të dhëna statistikore të analizuara nëpërmjet një databaze, ai nuk nxjerr përfundime mbi pasurinë e subjektit nëse ajo mbulohet me burime të ligjshme ose jo, por mëton të informojë publikun mbi pasurinë e deklaruar të zyrtarit publik nëpërmjet një formati të thjeshtë dhe të kuptueshëm grafik.

Gjyqtari Edmond Islamaj, në "sitën" e vetingut, KPK: Pasuria e justifikuar, s'ka deklarim të rremë

Ditën e djeshme u zhvillua seanca dëgjimore për gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, Edmond Islamaj. Ai pritet të kalojë me sukses procesin e vetingut. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit lexoi raportin për Islamajn, prej ku rezultoi se ai ka pasuri me burim të justifikuar dhe nuk ka kryer deklarim të rremë. Sipas KPK, rezultoi që gjyqtari të ketë dy apartamente në Durrës, ku njëri është në pronësi të bashkëjetueses, 1000 m² tokë arë në Kavajë, dy garsoniere dhe garazh+dyqan të Shkëmbi i Kavajës, si dhe një autoveturë. Vetë gjyqtari Islamaj deklaroi se pasuria e tij dhe e familjes së tij



është e trashëguar nga gjyshërit. Sipas ILDKPKI, gjyqtari Islamaj ka pasuri të ligjshme, të justifikuar me burime dhe nuk ka bërë deklarim të rremë. Ndërkohë, KPK ka kryer një hetim të thelluar, ku ka pyetur edhe një dëshmitar në lidhje me deklaramet e pasurisë së gjyq-

tarit. "Gjyqtari ka apartament banimi me sipërfaqe 81.57 m² në Durrës, tokë arë 1000 m² në Karpën, Kavajë, të vlerë në vitin 2015. Aika llogari bankare që prej vitit 2000, fillimisht me vlerë 5 mijë euro, llogari bankare të krijuar më 2016 me gjendje 20 mijë euro. Islamaj ka në pronësi të bashkëjetueses apartament me 141.13 m² në Durrës, si dhe dy garsoniere të Shkëmbi i Kavajës. Ndërsa, në pronësi të gjyqtarit regjistruhet dhe një garazh+dyqan po në qytetin bregdetar. Gjyqtari ka një autoveturë të vitit 2008, të blerë 3 mijë euro. Sipas DSIK, gjyqtari është i pastër. Nga hetimet ka rezultuar se si gjyqtari Islamaj edhe bashkëjetuesja e tij kanë bërë deklarime ndër vite. Ndaj Islamajt janë bërë 6 denoncime nga qytetarët, të cilët

nuk kishin fakte e prova. Gjyqtari është i aftë profesionalisht", thuhet në raportin e KPK-së. Nga ana e tij, gjyqtari i cili ka qenë i pranishëm në sallë, e ka cilësuar korrekt gjithë procesin e vetingut, ndërsa ka kërkuar konfirmimin në detyrë. "Nuk kam asgjë të re për të thënë. Procesi ka qenë me dialog. Jam përgjigjur me korrektesë. Pasuria ime dhe e familjes sime është pasuri e trashëguar nga gjyshërit. Në vitet '90 jam bërë gjyqtar në një moshe fare të re. Kërkoj konfirmimin në detyrë", u shpreh gjyqtari Edmond Islamaj. Ndërsa më 8 qershor, në seancë dëgjimore pritet të dalë kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Bashkim Dedja.

Nën akuzë për kallëzim të rremë, pranohet gjykimi i shkurtuar për Doshin, Frrokun, Bamin



Gjykata e Tiranës ka pranuar ditën e djeshme kërkesën për gjykim të shkurtuar për deputetin Tom Doshi, ish-deputetin Mark Frrokun, si dhe Durim Bamin, të cilët akuzohen për "kallëzim të rremë", kryer në bashkëpunim, për një atentat të pretenduar nga ana e deputetit Doshi për eliminimin fizik të tij. Pretenca për të akuzuarit do të jepet më 20 qershor nga Gjykata e Tiranës. Sipas prokurorisë, tre të pandehurit e kësaj

dosjeje në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë krijuar prova të rreme, me qëllim për të ushtruar ndjekje penale ndaj Presidentit Ilir Meta. Çështja në fjalë ka të bëjë me pretendimet e Tom Doshit se Meta kishte urdhëruar vrasjen e tij bashkë me ish-deputetin e PD-së, Mhill Fufi dhe se këtë gjë ia kishte rrefyer mikut i tij, Mark Frrokun, por prokuror-

ia pas hetimeve arriti në konkluzionin se gjithçka ishte e sajuar dhe i mori të pandehur. Çështja e tyre kaloi në të gjitha gjykatat, nga ajo e Lartë, në Kushtetuese, pastaj tek Krimet e Rënda e në fund u rikthye në Gjykatën e Tiranës. Durim Bami u arrestua në 2 mars 2015 në pikën e kallimit kufitar të Hanit të Hotit, në rrethin e Malësisë së Madhe.

Shkak u bënë deklaramet publike të deputetit Tom Doshi se Bami ishte "rekrutuar" për eliminimin fizik të tij dhe të deputetit tjetër Mhill Fufi. Pas arrestimit, ai mohoi të kishte marrë porosi për vrasjen dhe pretendoi se ishte kërcënuar nga deputeti për t'u regjistruar duke folur për "skënarin" e eliminimit të tij. Pas tri vitesh qëndrimi në arrest

shtëpie, për atentatin e supozuar, Durim Bami doli në liri të plotë. Ndërkohë, ditën e djeshme ata nuk janë paraqitur në seancën e sotme gjyqësore, ndërkohë mësohet se prokuroria ka kërkuar marrjen me forcë të Doshit dhe Bamin. Por, gjykata e ka rrezuar në kërkesë të tillë. Për Mark Frrokun, prokurori i çështjes ka deklaruar se do t'i dërgojë sërish një fletë-thirrje, pasi të parën ia dërguan në burgun e Fierit, nga i cili ai u la i lirë pak ditë më parë.

Shoqërohen 20 persona. Policia: Hetime edhe për hakmarrje dhe konkurrencë

Vrasja mafioze e biznesmenit Vasil Dervishaj, dyshohet për prishje të pazareve të drogës

29-vjeçari u qëllua me plumb në kokë sapo doli nga makina

VLORE

Atentati mafioz i biznesmenit Vasil Dervishaj ka tronditur Vlorën mbrëmjen e së hënës. Një ditë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur tek ish-Kombinati i Peshkut në lagjen "Pavarësia" të këtij qyteti, burime zyrtare nga policia bënë me dije se 29-vjeçari, pronar i një biznesi kafeje dhe i një lokali është qëlluar për vdekje me plumb në kokë. Mësohet se në vrasjen e viktimës, baba i një fëmije të mitur kanë marrë pjesë tre persona. Pas ngjarjes së rëndë, forca të shumta policore kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimit. Mbi 20 persona janë shoqëruar dhe janë marrë në pyetje në lidhje me ekzekutimin e Vasil Dervishajt. Ndërkohë, është prangosur edhe një person i dyshuar si bashkëpunëtor në atentatin e ndodhur në qytetin bregdetar. Burime pranë grupit hetimor pohuan për "Gazeta Shqiptare" se po hetohet në disa pista për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarjeje. Sipas hetuesve të çështjes, vrasja mund të ketë marrë shkas për shkak të prishjes së pazareve të drogës, pasi 29-vjeçari ka qenë i dënuar më parë për trafik të lëndëve narkotike. Gjithashtu, policia po heton edhe në pista të tjera si vrasje për shkak të konkurrencës, konflikteve që viktima mund të ketë pasur kohët e fundit me persona të tjerë (para një viti e gjysmë ka pasur një debat me një tregtar tjetër të kafesë), por edhe për hakmarrje. Kjo e fundit, për faktin se vëllai i biznesmenit, Derlin Dervishaj ka vrrarë në vitin 2005, 17-vjeçaren

Joana Dudushi, e njohur dhe si "agjentja" Stela.

ATENTATI

Rreth orës 23:00 të së hënës, Vasil Dervishaj ndodhej në makinën e tij tip "Ford" me targa italiane "OD 476 AF", me të cilën po udhëtonte kur u qëllua në lagjen "Pavarësia". Biznesmeni i kafesë është qëlluar me armë zjarri, ndërsa në atentat kanë marrë pjesë tre persona. Me plagë në trup, 29-vjeçari ka mundur të dalë nga makina, por atentatorët nuk janë larguar pa u siguruar se ai kishte vdekur. Dyshohet se njëri prej tyre e ka qëlluar sërisht me plumb në kokë, duke e lënë të vdekur. Me pas autorët janë larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes me një automjet tip "Mercedes-Benz" ngjyrë e zezë, duke përfutur nga errësira dhe rruga e pandriçuar në atë zonë. Vetëm 30 metra larg vendit të ngjarjes është gjetur një kalashnikov, që ende nuk dihet se kujt i përket. Ndërsa, dy-



Vendi ku u vra biznesmeni

shohet se atentatorët kanë ikur në drejtim të Fierit. Pas sinjalizimit për vrasjen, policia ka ngritur postblloqe të shumta në rrugët e qytetit bregdetar, por pa mundur të kapin atentatorët. Ndërkaq, blutë kanë shoqëruar dhe marrë në pyetje shumë persona, përfshirë këtu banorë

të zonës, të afërm të viktimës si dhe persona të tjerë me precedent penalë. Burime nga policia e Vlorës deklaruan se ngjarja është drejt zbardhjes dhe se kanë ndaluar një person, i cili dyshohet të jetë bashkëpunëtor në ekzekutimin e Vasil Dervishajt.



Viktima Vasil Dervishaj

NGJARJA

Biznesmeni i Dervishaj është qëlluar me armë zjarri, ndërsa në atentat kanë marrë pjesë tre persona. Me plagë në trup, 29-vjeçari ka mundur të dalë nga makina, por atentatorët nuk janë larguar pa u siguruar se ai kishte vdekur. Dyshohet se njëri prej tyre e ka qëlluar sërisht me plumb në kokë duke e lënë të vdekur. Më pas autorët janë larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes me një automjet tip "Mercedes-Benz" ngjyrë e zezë.

PISTAT E HETIMIT

Burime pranë grupit hetimor pohuan për "Gazeta Shqiptare" se po hetohet në disa pista për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarjeje. Sipas hetuesve të çështjes, ngjarja mund të ketë marrë shkas për shkak të prishjes së pazareve të drogës, pasi 29-vjeçari ka qenë i dënuar më parë për trafik të lëndëve narkotike. Gjithashtu, policia po heton edhe në pista të tjera si vrasje për shkak të konkurrencës, konflikteve që viktima mund të ketë pasur kohët e fundit me persona të tjerë, por edhe për hakmarrje. Kjo e fundit, për faktin se vëllai i biznesmenit, Derlin Dervishaj ka vrrarë në vitin 2005, 17-vjeçaren Joana Dudushi, e njohur dhe si "agjentja" Stela.

Si u masakrua dhe u hodh në det 17-vjeçarja Joana Dudushi

Ekzekutimi i biznesmenit, hetime edhe për vrasjen 13 vjet më parë të "spiunes" së policëve të Vlorës

Fare", ndërsa vajza e njohur me emrin "Stela" ka pranuar publikisht në emision se ka qenë "spiune", por jo me qëllimin e futjes në burg të të implikuarve, por të njerëzve të thjeshtë. Ajo thotë se ka realizuar dy punë, kameriere në disa nga lokale si dhe spiune në Policinë e Vlorës, ku nga puna e dytë u ka sjellë mjaft të ardhura inspektorëve të policisë. Vajza "spiune" tha se dinte edhe kodet e brendshme të oficerëve.

RRËPIMI I STELËS

"Historia ime nisi nga pëpjekuria. Më pëlqenin minifundet, diskot, ndërsa familjarët nuk më lejonin. Një ditë, në kohën që sapo kisha mbaruar klasën e tetë, xhaxhai më qëllua me pëllëmbë, pasi më kishte parë të veshur në mënyrë ekstravagante, me minifund". Sipas saj, pasi xhaxhai i kishte qëlluar, para shtëpisë së saj kalon Alket Tafo, një oficer i policisë në Drejtorinë e Policisë së Vlorës. Vajza thotë se ai e kishte pyetur se përse po qante, ndërsa Joana u përgjigj se e kishte qëlluar



Biznesmeni Vasil Dervishaj

xhaxhai. Pas kësaj oficeri i kishte rekomanduar të futej brenda, të bënte ca shenja të dukshme në trup dhe të shkonte në polici dhe të denonconte veprimin e xhaxhait. "Pas rekomandimit të oficerit, shkova në shtëpi dhe godita fytyrën me unazë si dhe në të gjithë trupin", - thotë vajza. Në dhomë mori 129 dhe realizoi denoncimin. Shkoi në komisarjat dhe para oficerit të policisë Alket Bello realizoi kallëzimin, ndërsa shefi Marjan Hasani urdhëroi mjekun ligjor që të mundehej për të zmadhuar

rrahjen. Ky i fundit nga plagosje, e shndërroi në plagosje të lehtë.

REAGIMI I POLICISË

Genti Dervishi, shefi i Antitrafikut në Vlorë, deklaronte se vajza nuk ka qenë asnjëherë pjesë e policisë dhe as spiune. Ai tha se ajo është shoqëruar si prostitutë së bashku me shoqen e saj, Marsela Tufa. Vepirmentarinë e Joanës e di edhe gjyshja e saj. Para kamerave ajo tregoi se Alketi së bashku me disa policë të tjerë i kishin premtuar Joanës se do ta çonin në Akademinë e Policisë në Ti-

ranë. "Ata e kanë futur që të fuste në kurth njerëzit", tha gjyshja.

VRASJA E JOANËS

Derlin Dervishaj ka pohuar se e ka vrrarë Jonanën me thikë, pas mesazheve bezdisëse dhe kërcënimeve të kësaj të fundit. "Rreth orës 2 të natës më erdhi një mesazh nga Joana, ku më shante mua dhe të dashurën time. Nuk e ruajta më qetësinë. I thashë të dashurës se do ta rregulloja njëherë e mirë këtë punë dhe u nisa në drejtim të kabinës, megjithëse ajo u mundua të më ndalonte", - ka rrëfyer në polici Derlin Dervishaj. Tek kabina e plazhit të vjetër kishte takuar Joanën, ku i kishte kërkuar që ta linte rehat. "Në rrugicën ku edhe e vrra, i thashë të më linte rehat, por ajo më tundte letrën, duke më thënë se do të më denonconte. Nuk e përmbajta dot veten. Nxora thikën që e mbaja gjithnjë me vete dhe e godita disa herë. Nuk mbaj mend se sa", - ka rrëfyer i akuzuari. Më pas, ai ka shtuar se ka ecur në rrëzë përgjatë bregdetit, ka ngulur thikën fort në rënë, derisa nuk dukej më. "Ika në shtëpi, ku u lava dhe u mundova të qetësohesha, por në mëngjes erdhi e më kërkoi një polic. Menjëherë e kuptova se gjithçka do të zbulohej", - ka përfunduar i akuzuari për vrasjen e

POGRADEC - Një tjetër qytetar është dhunuar nga policia në ambientet e komisarariatit. Kë saj here denoncimi vjen nga një 28-vjeçar nga Pogradeci, i cili pretendon se është rrahur nga blutë. Është fjalë për Ilir Begon, banues në këtë qytet. I riu bëri me dije se është dhunuar, pasi ka goditur me shkelma makinën e policisë. "Më dhunuan gjatë shoqërim-it dhe qëndrimit në komisariatin e Pogradecit. Ng-



Ilir Bego

"Policët më goditën me grushte në gjoks dhe në krah"

Goditi me shkelma makinën e efektivit rrugor, 28-vjeçari: Si më dhunuan barbarisht në komisarariat

jarja ka ndodhur të hënën në mëngjes tek dera e Komisarariatit", tha 28-vjeçari, i cili pohoi se kishte goditur me shkelma gomat e makinës private të efektivit të qarkullimit, Bujar Xhyra. Shkak për reagimin mësohet të ketë

qenë një gjobë e marrë para dy vitesh. "Më morën me forcë dhe me tërhoqën zvarrë në Komisarariat. Ju kërkova falje për veprimin, por policët më dhunuan. Me goditen tre herë me grusht në gjoks. Efektivët me

goditën edhe në krah. Me mbajtën 9 orë në komisarariat dhe më pas më liruan. Dëmin e makinës së policit e kompensoi babai menjëherë. Kam frikë të denoncoj policët. Prokurori i Rrethit nuk pranoi të merrte denon-

cimin", -u shpreh Bego. Tri javë më parë (më 17 maj) një ngjarje e rëndë u shënuar në komisariatin e Korçës, ku humbi jetën në rrethana misterioze Enea Ftoi. Familjarët e tij akuzuan policinë për ushtrim dhune. Ndërkohë, një tjetër rast ndodhi në Shkodër, ku Ardian Kallami u vetëvar në banesën e tij, ndërkohë që familjarët pretendojnë se ngjarja ndodhi pas dhunës së ushtruar nga policia.

"Si dështoi plani i skafistit Antonio Summa, ngatërroi rrugën"

Sekuestrohen 671 kg kanabis në Karaburun, përfundon në pranga 29-vjeçari nga Orikumi

Policia: Më 20 maj droga do transportohej në Itali

Arbër Sulo

VLORE

Një sasi prej 671 kg kanabis është sekuestruar dje nga policia e Vlorës në gadishullin e Karaburunit. Ndërsa ka përfunduar në pranga një 29-vjeçar. Mësohet se lënda narkotike, e cila dyshohet se do të trafikohej në Itali u gjet dhe u sekuestrua në vendin e quajtur "Depot e Valanidhit gjatë operacionit të koduar "Karaburuni". Operacion ky i ndërmarrë nga strukturat e policisë vendore të Vlorës në bashkëpunim me Delta Forcë. Gjatë këtij operacioni u sekuestruan dhe 200 litra benzinë në 8 bidonë plastik. Ndërkaq, përfundoi në pranga i riu Bernardo Nezhaj nga Orikumi. Burime zyrtare nga blutë e qytetit bregdetar bënë me dije se "vijon puna për dokumentimin e plotë ligjor të këtij rasti si dhe për identifikimin e kapjen e të tjerë shtetasve të përfshirë në këtë veprimtari antiligjore. Materialet hetimore iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për veprën penale "Traffikimi i narkotikëve, kryer në bashkëpunim". Ndërkaq, burime policore sqaruan për "Gazeta Shqiptare" se sasia e drogës e kapur në Karaburun do transportohej për në Itali më datë 20 maj të këtij viti, por skafisti Antonio Summa nga Brindisi ngatërroi rrugën dhe u kap në brigjet e Sarandës me një gomone me dy motorë nga 150 kuaj fuqi të mbushur me 200 litra benzinë. Aktualisht 26-vjeçari italian është nën masën e sigurisë. Ndalimi i daljes jashtë shtetit, "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" si dhe "Ndalimi dhe detyrimi i qëndrimit në një vend të caktuar". Masë kjo edhe nga Gjykata e Shkallës së Parë të Sarandës më 22 qershor të këtij viti, pasi Antonio Summa akuzohet për veprat penale: "Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror" dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", kryer në bashkëpunim. Gjatë këtyre dy javëve janë kryer hetime intensive nga policia e Sa-



Droga e sekuestruar në Karaburun



Skafi që iu sekuestrua 26-vjeçarit italian, Antonio Summa

randës dhe Vlorës që çuan në kapjen e kësaj sasive të madhe droge në Karaburun. Në deklaratimet e tij, të marra me cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, shtetasi italian Antonio Summa ka deklaruar se mjetin lundrues ia kishte

marrë një miku të tij, edhe ky shtetas italian, të cilin e identifikon vetëm me emrin "Cosimo". 26-vjeçari ka thënë se ishte nisur nga porti "Santa Maria de Leuca", i gjendur në zonën e Leçës, me qëllim realizimin e vizitës së brigjeve detare

greke, por për shkak të gabimit në orientim është gjendur në ujërat territoriale shqiptare. Nga kontrolli i ushtruar nga policia e Sarandës më 20 maj në mjetin lundrues të riut italian nuk është gjetur asnjë send i kundërligjshëm. Madje as

dokumentacioni identifikues, regjistruar apo i pronësisë së mjetit lundrues. Nga e ana e drejtuesit të mjetit lundrues janë paraqitur vetëm dokumentet "librezë", që i përkisnin motorëve të instaluar në mjetin lundrues.



Grabitet pika e këmbimit valutor në Manzë, në kërkim autorët

DURRËS - Një pikë e këmbimit valutor është grabitur në orët e para të mëngjesit të djeshëm në Manzë. Burime zyrtare nga policia e Durrësit dje bënë me dije se persona ende të paidentifikuar kanë bastisur dyqanin në pronësi të 71-vjeçarit me inicialet E.D.. Sipas hetuesve të çështjes, autorët kanë dëmtuar qepenin dhe pasi kanë hyrë brenda kanë vjedhur xhiron ditore. Ka qenë pranoi i biznesit ai që ka njoftuar blutë. Deri më tani nuk dihet shuma e grabitur, ndërkohë që policia po punon intensivisht për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimit. Materialet procedurale i janë përcjellë prokurorisë së këtij rrethi për hetime të mëtejshme.

Entela Ftoj: Prej 2 javësh flemë në qiell të hapur

Bashkëshorti humbi jetën në paraburgim, nëna e 3 fëmijëve: Më gjeni strehë, ose do var veten

KORÇË - Afro tri javë pas vdekjes së 27-vjeçarit Enea Ftoj në ambientet e paraburgimit të Korçës, bashkëshortja e tij apelon për ndihmë. Entela Ftoj tha dje për "Gazeta Shqiptare" se bashkë me tre fëmijët e saj të mitur fle në qiell të hapur. Ajo tregoi se prej dy javësh fle tek pazari i Korçës dhe në lulishten e qytetit, pasi nuk ka strehë ku të fusë kokën. Mes të tjerash ajo i bën thirrje shtetit që ta ndihmojë që t'i japë një strehë, në të kundërt paralajmëron se do të vrasë vet-



Viktima Enea Ftoj

en. "Që prej dy javësh fle jashtë bashkë me fëmijët. Herë te pazari dhe herë në lulishten e qytetit. Nuk kam

asnjë të ardhur. Fëmijët prej disa ditësh nuk ushqehen dhe askush nuk më ka ofruar ndihmë. Kërkoj një shtëpi ku të strehohem bashkë me fëmijët. Në të kundërt, do var veten. Policia që më vrau burrin, të na vrasë edhe ne", -u shpreh Entela Ftoj. Bashkëshorti i saj, Enea ndërroi jetë më 17 maj në ambientet e paraburgimit të Korçës, ku kishte tre ditë që qëndronte pasi ishte ndaluar për "vjedhje me dhunë". Ditën kur ndodhi ngjarja, pritej që ai të dilte në sallën e gjyqit për



Entela Ftoj duke folur për "GSH"

akuzën që rëndonte ndaj tij. Familjarët e prisnin atë në sallën e gjyqit, kur u njoftuan për vdekjen e tij. Pas lajmit të kobshëm,

familjarët e viktimës akuzuan policinë. Ata u shprehën se Enea humbi jetën për shkak të dhunës së ushtruar ndaj tij.

Instalohet akseleratori tjetër në ndihmë të të sëmurëve. Rama, inspektim në repart

Voltiza Duro

Pajisja për trajtimin e tumoreve në QSUT, jashtë funksionit

Pacientët: Në pritje të shërbimit prej dy javësh, kemi zënë radhën

Ditën e djeshme pranë Shërbimit të Neurokirurgjisë në QSUT është instaluar akseleratori i dytë linear për trajtimin e sëmundjeve tumorale, edhe pse i pari vazhdon të jetë jashtë funksionit. Pacientët prej 15 ditësh kanë mbajtur radhë në dyert e repartit të radioterapisë, me shpresën se akseleratori do të rregullohet. Por mesa duhet nuk kanë mundur ta marrin shërbimin që iu nevojitet për trajtimin e sëmundjeve tumorale. Një prej pacientëve (kërkon të ruajë anoniminat) tregon për "Gazeta Shqiptare" se ka plot 15 ditë që sorollatet dyerve të QSUT-së, por pa marrë shërbim. "Kam mbi dy javë që vij përditë në derën e Neurokirurgjisë, se duhet të marr trajtimin nëpërmjet akseleratorit, por pajisja nuk punon. Na kanë thënë që po rregullohet, por mesa duket ende nuk kanë arritur ta sjellin sërish në gjendje pune, sepse ne vijmë përditë këtu e mbajmë radhën. Këtë shërbim nuk e marrim dot as në klinikat e spitalit private, pasi nuk ka akselerator asnjëra prej tyre. Shpresojmë që me ardhjen e pajisjes së re të Neurokirurgjia të marrin fund sorollatjet tona, edhe pse ka dalë lista e pacientëve që e kanë domosdoshmërisht të



Dje në shërbimin e neurokirurgjisë

nevojshëm shërbimin. Më duhet patjetër për trajtimin e metastazave në tru", - tregon pacientin, i cili po pret pranë Neurokirurgjisë. Ndërkaq, burime zyrtare nga Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" bëjnë me dije për



Edi Rama në QSUT

"Gazeta Shqiptare" se është inauguruar akseleratori i ri pranë Neurokirurgjisë. "Sot (dje) është inauguruar akseleratori i ri, pra pajisja e re e rrezeve që do t'u vijë në ndihmë pacientëve. Ndërsa, për sa i përket problemeve me akseleratorin e vjetër, mund të them se ky lajm nuk është i vërtetë", - bëjnë me dije burimet nga Drejtoria e QSUT-së. Sipas ekspertëve, një akselerator mund të trajtojë deri në 45 pacientë në ditë, e nëse edhe pajisja e vjetër do të funksiononte, do të trajtoheshin 90 të tillë, me instalimin e akseleratorit të ri.

45

PACIENTË TË TRAJTUR

Sipas ekspertëve, një akselerator mund të trajtojë deri në 45 pacientë në ditë, e nëse dhe pajisja e vjetër do të funksiononte, do të trajtoheshin 90 të tillë, me instalimin e akseleratorit të ri.

AKSELERATORI I RI
Në repartin e radioterapisë pranë shërbimit të Neurokirurgjisë në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" është instaluar akseleratori linear i dytë. I pranishëm në inaugurimin e pajisjes ishte edhe kryeministri i vendit, Edi Rama, (ishoqeruar nga ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Mbrojtëri, i cili u shpreh se është zgjidhur përfundimisht problemi i trajtimit të pacientëve të onkologjikut me herceptinë, medikamentin e domosdoshëm për trajtimin e tumoreve të gjirit. "Kuptohet se gjërat nuk mund të bëhen të gjitha për një herë, por të flasësh sot për Onkologjikun dhe për trajtimin që marrin pacientët, është si të harrosh se katër vite më parë reparti

ishte një paradhomë e botës tjetër", - tha Rama në fjalën e tij. Radiokirurgji është shërbimi që ka të bëjë me trajtimin e sëmundjeve kirurgjikale dhe brenda ditës sëmundja është e shëruar. Prej afro 5 vitesh në QSUT, aplikohet edhe ajo që quhet radioterapi që mund të kryejë radioterapi dhe radiokirurgji në çdo pjesë të trupit me saktësinë e milimetrit. Ndërkohë, një pacient me sëmundje tumorale mund të ketë nevojë për kirurgji, kimioterapi, radioterapi apo radiokirurgji, ku tumori bombardohet me anë të rrezeve, por për këto vendos një ekip i specializuar mjekësh. Radiokirurgjia nuk ofrohet as në klinikat jopublike në vend dhe as në vende fqinje si Maqedonia dhe Mali i Zi.

SHKURT

Klosi: Kostot për reduktimin e mbetjeve, minimale

Rqeseve plastike është bërë qëllimisht duke synuar reduktimin për përdorimin e tyre. Kjo është përgjigja që i ka dhënë ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi, biznesit në Ditën Ndërkombëtare të Mjedisit, ku ka bërë thirrje për bashkëpunim për ruajtjen e tij. Ministri u bëri thirrje që qytetarëve për refuzimin e qeseve që nuk biodegrodhen. Klosi theksoi se kostot për reduktimin e mbetjeve nuk janë të larta, ato bëhen edhe më minimale duke përdorur teknologjitë e reja.



Të rinjtë e kryeqytetit shpërndajnë llamba ekologjike

Duke filluar nga data 1 korrik hyn në fuqi vendimi i qeverisë, që nuk do të lejojë më përdorimin e qeseve plastike. Në ditën Botërore të Mjedisit, disa të rinj, të shpërndarë në pika të ndryshme të Tiranës, zgjedhën një mënyrë origjinale për të falënderuar qytetarët që kishin zgjedhur biçikletën si mjet lëvizës, duke iu dhuruar atyre, në shenjë mirënjohjeje, llamba LED miqësore me mjedisin e që kursejnë energji, si dhe nga një çantë beze për të zëvendësuar qeset plastike. Kësaj nisme iu bashkua edhe kryebashkiaku Erion Veliaj. Ndërkohë, pas mbjelljes së mbi 120 mijë pemëve, Tirana është qyteti i parë në Ballkan që ka sjellë sistemin e biçikletave pa stacion "Smart Bike Sharing", një mënyrë ekologjike dhe inovative për të lëvizur në qytet.



**MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
NJOFITIM PËR PJESËMARRJE NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE,
PËR ANËTARËSIMIN NË KËSHILLIN TATIMOR**

Në zbatim të kreu I, pika 2 të VKM nr.665, datë 4.8.2010 "Për përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të këshillit tatimor, si dhe të kontributeve financiare të anëtarëve, që përfaqësojnë tatimpaguesit në këtë këshill", Ministria e Financave dhe Ekonomisë, fton përfaqësuesit e tatimpaguesve nga dhomave të tregtisë dhe industrisë, të shoqatave profesionale të ekspertëve kontabël, të shoqatave në fushën e ndërtimit/aritekturës/inxhinjerisë që përfaqësojnë grupe të mëdha tatimpaguesish të marrin pjesë në procesin përzgjedhës për t'u anëtarësuar në Këshillin Tatimor.

Për përzgjedhjen e anëtarëve, përfaqësues të tatimpaguesve, në Këshillin Tatimor, ndiqen këto kritere:

- a) Përfaqësimi i tatimpaguesve, në Këshillin Tatimor, duhet të marrë në konsideratë kriterin e përfaqësimit gjeografik të tatimpaguesve, të kategorive të ndryshme të tatimpaguesve, si dhe të sektorëve të ekonomisë ku ata zhvillojnë veprimtarinë.
- b) Përfaqësuesit e tatimpaguesve, në Këshillin Tatimor, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - I) të kenë përvojë profesionale prej jo më pak se 3 (tre) vjet në çështje të administrimit të biznesit në Shqipëri;
 - II) të jenë anëtarë të një shoqate ose organizate të llojeve të përcaktuara në mënyrë sipër, dhe të autorizohen, me shkrim, nga titullari, për të përfaqësuar shoqatën ose organizatën;
 - III) të kenë përvojë të punës në grup dhe aftësi të mira komunikuese.

Dokumentacioni i nevojshëm për pjesëmarrje në procedurën përzgjedhëse dorëzohet brenda datës 28.06.2018, pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në adresën: Biv "Dëshmorët e Kombit" nr.3, në një zarf të mbyllur me mbishkrimin "Për Sekretariati Administrativ i Këshillit Tatimor".

- a. Formulari i aplikimit gjendet i publikuar në faqen zyrtare në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, www.financa.gov.al/al/newsroom/njoftime-dhe-aplikime
- b. Kopje e noterizuar e aktit ligjor të regjistrimit të organizatës;
- c. Letër për emërimin zyrtar të përfaqësuesit të organizatës në Këshillin Tatimor, e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i organizatës;
- d. Curriculum Vitae e personit që do të përfaqësojë organizatën tuaj në Këshillin Tatimor, ku të jetë evidentuar qartë edhe përvoja profesionale në fushën e taksave (jo më pak se tre vjet).

Duke vlerësuar maksimalisht kontributin e përfaqësuesve të tatimpaguesve në përmirësimin e sistemit fiskal, inkurajojmë të gjitha organizatat që plotësojnë kriteret e mësipërme, të marrin pjesë në procedurën e përzgjedhjes për t'u anëtarësuar në Këshillin Tatimor.

STRATI Shoqëria përbarimtare "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

- "Ndërtësë", me sipërfaqe 44 m², ndodhur në Selenicë, Kolonjë, me Nr. 570/49-ND Pasurie, vol. 7, faqe 249, Zona Kadastrale 3284, regjistruar në pronësi të Shkëlzen Sulejmani. Çmimi fillestar i ankandit është 201.600 Lekë.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 11.06.2018. Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përbarimtare "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

Procedurat për certifikatën e pronësisë ndiqen nga 'Agjencia'

Ornela Manjani

ALUIZNI publikon listën me 320 pronarë të qatë kanë gati lejet e legalizimit në qarkun e Lezhës. "Vetdeklaruesit që kanë emrin në listë duhet të paraqiten pranë zyrave të ALUIZNI-t në Lezhë me dokument identifikimi për tërheqjen e lejes së legalizimit. Për të gjithë vetdeklaruesit e tjerë që nuk figurojnë në këtë listë ju informojmë se nga ana e ALUIZNI-t Lezhë po punohet në mënyrë intensive për pajisjen e tyre me leje legalizimi"- bën të ditur Drejtoria e ALUIZNI-t të Lezhës. Përfituesit duhet të tërheqin lejen e legalizimit dhe më pas presin që Agjencia e Legalizimeve të ndjekë procedurën për pajisjen e tyre me

ALUIZNI: 320 personat që kanë gati lejet e legalizimeve

Lista me pronarët në qarkun e Lezhës

certifikatën e pronësisë.

TAPIA

Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë në Zyrën e Regjistrimit të

Pasurive të aplikojnë për tapinë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesin të legalizimit, por gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të

Pasurive të Paluajshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për

ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat, për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shiten

poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin, nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirish dhe të depozituar brenda afatit të vetdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese edhe pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.

320 PERSONAT QË KANË GATI LEJET

ZEFNDUE GJINI
ARIAN MARK NIKOLLAJ
09_8294814 JAK GJERGJ GJONI
09_2105682 GJON NIKOLL GJONI
09_2130048 GJOVALIN PREND MARKU
09_2130895 KUJTIM ZEF MESULI
09_2135945 PRENGE NDRECE TUÇI
09_2129622 PAL PRENG PRENGA
09_8295301 MENTOR ZEF NIKOLLI
09_3012877 GJON ZEF NIKOLLI
09_2130078 FRROK LLESH GJERGJI
GJIN PJETER LLESHI
09_2125260 PREND PJETER MANDREU
09_2130058 PRENG ZEF SHQUTI
09_2128819 GJERGJ KOL GJERGJI
09_2127409 SERVET FERIT SHAHINAJ
09_2123992 TONIN DED PEPA
09_2127838 PAL DED GJINI
09_2128893 PRENG NDUE KOLA
09_2127773 PRENG ZEF NDOJ
09_2126693 AGRON PJETER LLESHAJ
09_2129985 AGRON PRENG DODA
09_2081148 NIKOLL ZEF MARKU
09_2081257 NIKOLL GJETE GJIKA
09_2130896 PRENG BARDHOK DODANI
09_2130046 FRAN MARK PERSHPALI
09_2130889 LLESH NDUE PERGJOKA
09_2131984 NDRECE PJETER MARKU
09_2129658 VIKTOR NDUE FRROKU
09_2129634 EDMOND NDRECE NDOCI
09_2075720 EDIART GJIN KOLMARKAJ
09_2120930 NURI HYSEN MITKU ;
PELLUMB HYSEN MITKU , SHPETIM
HYSEN MITKU
09_2129724 PREND XHEM DODA
09_2128395 ZEF NDUE GEGA
09_2130039 NDUE MARK KACURRI
09_2124005 DEMIR ZYLAL CANO
09_2125733 VIKTOR NIKOLL SOKOLI
09_2121540 ARBEN LAZER PERGJONI
09_2126708 GJON MARK GJONI
09_2132347 KUJTIM NDRECE KARAÇI
09_2129636 PRENG JAK MARKU
09_2118824 LLESH PRENG DODA
09_2126803 TOM PRENG NDOCAJ
09_2138520 ZEF LLESH BICI
09_2138402 LUKË PRELE MARASHI
09_2075690 ARBEN RAMAZAN GEGA
09_2128328 GJETO GJERGJ LUCAJ
09_2121059 ISUF RIZA ÇIKU
09_2132942 PRENG NDUE PËRVATHI
09_2128454 ZEF GJIN NDOJ
09_2126526 PETRIT GJIN GPOLAJ
09_2137310 PASHKALIN NDUE MUCUKAJ
09_2135794 MARTIN GJERK CALI
09_2120964 DASHAMIR LJK REÇI
09_2128439 ISMAIL QAZIM MEMA
09_2134288 DED MARK PRENGA
09_2131939 PETRIT MARK NDRECA
09_3010891 NDRICIM LLESH DODA
09_8175155 ALEKSANDER PJETER KOLA
09_2136094 NDRECE PRENG LEK GEGAJ
09_2138490 GJOVALIN NDUE BIBA
09_2127081 DRANE PRENG BEZHI
09_2133021 GJERGJ PRENG NDOJ
09_2121613 TOM MARK PRELAJ
09_8305644 MARASH NDUE LUCI
09_2123981 PAL PJETER JAKU , LUÇIJE
PREN JAKU

09_2131747 NDUE LAZER BALOZI
09_2105829 GJOVALIN MARK LUSHI,
VIKTOR MARK LUSHI
09_2133358 GJEKE NDOCE PRELASHI
09_2131713 NEZIR BEGTASH BEGA
09_2127024 GJERGJ MARK PALOKA
09_2127399 LEKE NIKOLL MHILLI
09_2127266 ILIRJAN BIB KACAJ
09_2127004 MHILL GJON NJEÇI
09_2132542 PRENG LEK PERJAKU
09_2126307 BARDHOK PREND PRENDI
09_2127758 DOD NDOCE LEKSTAKAJ
09_2124119 ERMIR LUIGJ LEKSTAKAJ
09_2125332 GJERGJ GJIN NIKOLLI
09_2127815 PASHKO MARKO NDOCI
09_2124125 PJETER PASHKO PJETRI
LLESH TOM NISHAJ
09_2132648 PAL ZEF GJERGJI
09_830786 GJERGJ NIKOLL JAKU
09_2134326 BARDHOK KOL MIZA
09_2131826 PJETER NIKE UCI
09_2126437 LUIGJ PREK DULI
09_2126440 MATUSH LEK UCAJ
09_2126342 MIRASH MARK DULI
09_2125326 PRENG NIKOLL LUPI
09_2126318 GJON LLESH LLESHI
09_2123737 ALFREDE MARK RROZHANI
09_2122916 ZEF NDOCE RROZHANI
LEKE DEDE NDRECA
09_2123070 GAC LAZER ZEFI
09_2122842 RAFAEL GJOK KASNECI
09_2123105 GJOKË NDOCE SHTJEFNI
09_2123604 PJETER GJERGJ MAZRREKU
09_2123552 FRED LUIGJ PALOCI
09_2123605 NIKOLIN MARK TUSHAJ
09_2123679 LLESH GEG GAZULLI
09_2122580 HAXHI XHEMAL ZIRA
09_2121406 DEDE MARK DEDA
09_8176203 ARTAN MHILL GEGA
09_2120181 FILIP GJON PRENGA
09_2120157 NDUE JAK NIKOLLI
09_2120394 GJIN ZEF PEPA
09_2129448 SALVATOR LAZER LUPI
09_2123799 ZEF NIKOLL MULA
09_2103018 NAIM SELMAN MYRTA
09_2129527 FLORIN KOL MHILLI
09_2138405 AGOSTIN PJETER LULAJ
09_2126445 PAL MARK PRENDI
09_2126445 PETRIT MARK PRENDI
NDUE PRENG PERDODA
09_8173993 DODE FRROK ZEFI
09_2120100 GJON ZEF NIKOLLI
09_2115779 LULASH GASPËR DEMAJ
09_2134469 PASHK GJON KOLA
09_8140235 ARTAN GJERGJ MARKU
09_8174028 LLESH NDUE DEDA
09_8303559 VASIL NDUE HAXHIA
09_2107713 PETRIT LLESH MARKU
09_8141027 ALTIN PJETER PRENGA ,
ANTON PJETER PRENGA
09_2131997 DOD LLESH JAKU
09_3012138 AUREL ZEF VOKIRI
09_2137214 NDUE GJIN MARKU
09_8294566 GEG GJIN NIKOLLA
09_8294567 VALBONA RASIM DUSHAJ
09_8140811 MARK PAL LLESHI , MARTE
GJIN LLESHI
09_2138483 LEK JAK GJINI
09_2115744 VATE UKSHIN ZEFI

09_2130551 SHKELQIM PASHK NDOJ
09_2121605 PAULIN NDUE PALOKA
09_8172383 MARK NDUE LLESHI
09_2105737 PAL GJERGJ DEDGJONAJ
09_8173269 ARBEN GJON DODA ;
VALBONA ABAZ RRUSTJA , BUJAR
XHEVAT SHKODRA , ETJ
09_2129957 PRENG NDUE MARKU
09_8174971 ENVER SAMI ISMAILAJ
09_3012817 BIB LUK VORFAJ
09_8301296 PASHK PJETER ÇERRI
09_8140871 PETRIT GJERGJ LULA
09_8173733 GANI HASAN LIKA
09_1000680 AVNI REXHEP MEKRIZVANI
09_8140950 PRENG GJERGJ MARKU
09_8139756 MAJLINDA GJIN ÇUPI
09_8307785 SHAQE ZEF KOLA
09_8307895 SAMI RIZA DUSHKU
09_1000879 KUJTIM OSMAN DAJA ,
RESHIT ZYMER METVELAJ
09_2113022 MARK NDRECE MARKU
09_8173147 GJIN NIKOLL RAMA
09_2078395 DRITAN NDUE PJETRI
09_2136040 GJON PRENG MARKU
09_8307101 GJON LLESH VATA
09_8174875 BASHKIM TOSUN BRIHMANI ,
SIMON TOSUN BRIHMANI
09_3012818 BARDHOK BIB VORFAJ
09_8307100 PJETER MARK DODA
09_8173145 GJERGJ NIKOLL METAJ
09_2135998 ARBEN PRENG NIKOLLI
09_8177783 MRJ TOM BACAJ , PJETER
ZEF BACAJ , ELVIS ZEF BACAJ ; ENGJELL
ZEF BACAJ
09_8174018 MONDI NIKOLL NDOJ
09_8295562 ROZAF DODE KOLA
09_8140313 PREN FRROK PALAJ
09_2121073 GJOK MARK GJETA
09_3011996 MARIËN GJETO LEKAJ
09_2130186 AGRON PASHK KROSI
09_8307108 ASTRIT LLESH SHKORRETI
09_8174660 GJOVALIN ZEF LLESHI
09_8302831 BARDH MARK PRENDI
09_8307079 DOD ZEF NDOCA
09_8176540 ENRIK PAL SHTINJA
09_8307127 MARK PRENG SULI
09_8307860 VASEL GJOKË NDREU
09_2128464 PASHKO PREL LINI
09_8140776 SOKOL PRENGE PRENGA
09_8307114 ASTRIT LLESH SHKORRETI
09_8306273 LEONARDO PASHK TUSHAJ ,
RIGERTA KOL LOKU
09_2132522 FRAN MARK GJINI
09_3011078 VASE NDREKE GAZULLI
09_2120948 GJERGJ PRENG RICA
09_8177685 SIMON NIKOLL STOJANI
09_8177937 GASPËR LUK MARASHI
09_8139442 KOLE MARK MARKU
09_8174891 PASHK NIKOLL KOLZIU ,
MARIO NIKOLL KOLZIU
DITURIE F LLESHI ZEF P
PRENDI BARDHE L PRENDI IRMA Q
ZYBERI , ARDITA Q ZYBERI , ETJ
09_8138564 PETRIT PRENG ÇUNI
09_2135750 GJERGJ MARASH IVANAJ
09_8295289 GJOK ZEF BOÇI
09_8304502 AGRON NIKOLL TOMAJ
09_8139064 XHEVALIN NDUE LEPURI
09_8138889 XHEVALIN NDUE LEPURI

09_8176816 MARTIN DED GJOCI
09_8138878 GJERGJ NDUE LEPURI
09_8308334 NDUE FRROK PEPA
09_8307836 FISNIK ZENEL AGUSHI
09_1007265 TONIN NIKOLL NIKOLLI
09_8305608 NDUE NIKOLLE FRROKU
09_2130311 AGUSTIN GJERGJ PJETRI
09_8173485 PRENG DED GJETA
09_8174983 FATMIR GEG HYSAJ
09_8174983 NDUE GJON GEGAJ
09_2130318 ZEF SHAN GJERGJ NDREAJ
09_8174673 LEKE GJIN LASKA
09_2127229 HAMIT SHABAN LIKA
09_2130857 PASHKO GJERGJ KOLA
09_2131859 NDRECE PRENG NIKOLLI
09_8294525 GAZMEND PRENG NIKOLLI
;GJERGJ PRENGE NIKOLLI , PRENG MARK
NIKOLLI
09_8176447 MUHARREM RAMAZAN REÇI
09_2128621 DEDE LLESH GJEGJA
09_2127141 NIKOLL ZEF PULAJ
09_8302844 XHOANA DED GJINI
09_8138880 FRAN ZEF PRENGA
09_8178339 EDI NIKOLL NEKAJ
09_2126470 KRISTIAN PREL LIKAJ
09_2127240 VINJOL DED NDREU
09_3008092 GJELINE RROK LLESHAJ
09_2129738 KUJTIM VIKTOR FRROKU
09_8140735 GJOK LLESH VATHI
09_2123021 LUIGJ DOD DODA
09_8173545 BARDHOK GJON RRIKA
09_8307848 NIKOLL KOLE DAKAJ
09_8139667 HIL KOL NDRECA
09_8308382 GJEVALIN NDOCE MIRI
09_8308383 GJEVALIN NDOCE MIRI
09_8139553 DED NIKOLL PRENDI
09_2124166 NDRECE PASHUK VOKAJ
09_8174342 MARKA PASHUK TOMA
09_8177805 AGRON TAF REÇI
09_8138578 PRENG LLESH GJOKA , VITORE
NIKOLL LLESI , AGE NIKOLL PIROLI , ETJ
09_8176052 PASHKO FRROK BARDHAJ
09_8307837 ASTRIT SOKOL ALLJA
09_8307863 DELI SHABAN REÇI
09_8307094 KASTRIOT GJOK GJEÇI
09_8307088 ZEF NIKOLL NIKOLLI
09_8306326 ALEKSANDER DOD LESAJ ,
ARLINDA LLESH HOJ
09_2132520 PRENG LLESH KAÇORRI
09_2120974 LUIGJ GJIN SHTINJA
09_8302806 FERDINANT DED MIRUKAJ
09_8295303 MENTOR ZEF NIKOLLI
09_2124050 PETRIT GJERGJ PEMAJ
09_2122876 LAZER MARK BUSHI
09_2130202 PAULIN PRENG PALOKA
09_2126650 GEZIM NIKOLL PRENGA
09_2123076 GEG GJERGJ VASA
09_2115848 FLAMUR PRENG MARKU
09_8175418 FLAMUR PRENG MARKU
09_2130201 ASTRIT PRENG PALOKA
09_8307841 GJOVALIN MARTIN DUSHAJ
09_3009007 GEG ZEF GJOKA
09_8307835 SOKOL PREL KOLNDREU
09_8172995 NDUE GJIN NDRECA
09_2126707 MARK PRENG NIKOLLI
09_8139722 NIKOLIN ZEF MOLLA
09_2131668 PRENG FRROK NIKOLLI
09_3010214 BARDHOK PRENG GJOKA
09_8172475 DRITAN DOD MARKU

09_2127189 MARTE NDOCE GJINAJ
09_8308337 HYLMIZ ZENEL GURI
09_3009104 ROBERT ALEKSANDER
LUMSHI
09_2124045 ALFRED KEL SALLAKU
09_2126535 PRENG ZEF PERNDRECA
09_2122868 SARAFIN NDRECE SIMONI
09_2125766 DEDE NDOCE LUCA
09_2081277 ZEF PJETER NIKOLLI
09_2129278 PRENG NIKOLL LLESHI
09_3013083 HILE PJETER KOLA , ETTLEVA
HAKI DAMZI , HAMZA YMER HOTI
09_2134360 MARK GJON DODA
09_2127275 SHKELQIM ISMAIL
KRAHMANI
09_2126884 KASTRIOT PREÇ SULAJ
09_2128588 NIKOLL ZEF PJETRI
09_8301283 KUJTIM HAJREDIN PRETHI
09_2123680 VLASH GEG GAZULLI
09_2120140 ARDIAN GJERGJ LUCAJ
09_2123760 ZEF SHUK LAZRI
09_2132929 LEK FRROK NDOCI
09_21233027 MARASH LAZER PALOCI
09_2122841 PALOK MARK MARKU
09_2102963 BIBE NDRECE MARKOLA
; MARJE GJON PEPKOLAJ
09_2137237 LLESH PASHK MRRUKU
09_2081261 MARIAN PASHUK DODA
09_20124095 PJETER GJERGJ KOLA
09_2135963 ELJONA MARK STOJANI
09_8140575 PRENG NIKOLL NDOCI
09_8175678 SHAQE ZEF NOKA
09_2126574 NIKOLL PRENG GJONAJ
09_8177822 NIKOLL NDUE LUKA
09_2128421 NDRECE DED GJOKA
09_2131755 ALLAN MEXHIT KOÇI
09_2131697 GAZMIR HANAN DIFAJ
09_2105765 ANDREA NDUE VORFI
09_2118139 VITOR PRENG PRENDI
09_2000045 MARTE GJIN GJERGJI
09_7000664 FRAN GJON BIBA , XHEMI
ELMAS DAÇI
09_2129662 ZEF PJETER GJINI
09_301212 GJERGJ PAL GJINI
09_2127714 XHEVAHIR MARK GJINI
09_2127251 BIB PRENG BECI
09_2120088 NDUE GJIN DEDA
09_8175453 PETRIT NIKOLL NDRECA
09_3013057 MARK DODE PERNOKAJ
09_8139210 SOKOL PRENG UKA
09_8139141 ISMAIL ADEM HYSA
09_8141070 FRANO GJERGJ GJERGJI
09_3008276 PAQSOR FRANG PALUSHI
09_8173756 PJETER NDUE LLESHI
09_3008277 ARBEN PRANG PALUSHI
09_8172744 FILE MALIQ ZEQJA
09_2123149 LEK RROK LUMSHI
09_3011140 DED ZEF MARKU
09_2123149 KOLE PRENG FRROKU
09_2130225 SANDER MARK BARDHI
09_8175633 AGLENTIN MATUSH LLESHAJ
09_2127254 LEK GJERGJ ÇOKU
09_2125384 NDRECE DED DEDA
09_2131972 LEKE GJIN NDOJ , PETRIT GJIN
NDOJ
09_2130134 GJON NDUE GJINAJ

Dosjet e viteve 1993-2008, formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë vendimeve

Ornela Manjani

Pronarët në Shkodër, ATP merr në shqyrtim 4400 dosje

Problematikat, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 4400 dosje ish-pronarësh, që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkesit janë në qarkun e Shkodër. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit, gjeneralitetet e kërkesit, sipërfaqet e njohura për kompensim, dosjet për pronarët që kanë marrë vendim negativ dhe dosjet që duhet të plotësohen. Dosjet janë të viteve 1993 deri në vitin 2008. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vënë në dispozicionin të pronarëve formularin-tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në 'Agjenci' për t'u njohur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia Trajtimit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

FORMULARI

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tri seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjen-

eralitet, adresën dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përshkruar në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkon informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuara pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

APLIKIMI

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes, subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së kërkesën përkatëse me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie

DOKUMENTACIONI QË DUHET TE PARAQISNI

- Formulari-tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish-KKP/AKKP (nëse ka)
- Dokumente të tjera

dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në 'Agjenci'. Më pas, kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon, ia dërgon të gjitha kërkesat e ardhura drejtorit të përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sek-

torit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas, sektori përkatës përgatit informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën e kthimit të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë, sipas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.

SHKODER

Nr./Dosjes	Data/Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti Kërkes)	Mbiemri (Subjekti Kërkes)	Sip. E Njohur/Mosnjohje M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika
51	12.06.1994		Malesi e Madhe		375		
57	03.08.1994		Trash. Dokaj		240		
47	10.06.1994		Trash. Lulati		200		
60	05.08.1994		Nik	koti	10600		
45	30.03.1994		Trash. Koka		663		
53	27.06.1994		Trash. Kurti		800		
20	01.12.1993		Malesi e Madhe	Leopod	2400		
-	-		Malesi e Madhe	Trash. Kronaj	1200		Ne dosje ndodhet edhe v. 6/1 dt. 25.02.1997 i cili njeh sip 4600 m ² truall, kthen 3126 m ² dhe kompenson 520 m ² . Prona ndodhet ne Troshan Razem te komunes Shkrel.
27	31.01.1994		Malesi e Madhe	Trash. Smakaj	3257	962	
6	15.05.2000		Malesi e Madhe	Trash. Camaj	2000		Ne dosje ndodhet dhe vendimi 6, qe i perket dosjes nr. 7, dhe vendimi 7 qe i perket dosjes nr. 8, ne emer te sub. te tjere . Te tre vendimet e cituar te ish KKKP , jane dhene ne emer te sub. Te ndryshem te shpronësuar. V 7, dt. 18.05.200, dhe nje vendim gjykatë janë sekuestruar nga prokuroria me dt. 26.10.2010.
8	31.05.2000		Malesi e Madhe	Kuvendi Franceskan	244580		
11	29.10.1993		Malesi e Madhe	Trash. Cobes	1000		
29	10.03.1994		Malesi e Madhe	Trash. Gjerkaj	300		
46	24.03.1994		Malesi e Madhe	Trash. Rragami	206	206	
34	22.03.1994		Malesi e Madhe	Trash. Pacaj	7813	2613	
4	21.10.1993		Malesi e Madhe	trash. Gjetja	9713	3913	Ne dosje ndodhet edhe v. 13/1 dt., 28.6.95 me te cilin i eshte njohur dhe kthyer sub. sip 800 m ² truall e ndodhur ne Razem.
25	08.02.1994		Malesi e Madhe	Trash. Vulaj	2897		
17	17.11.1993		Malesi e Madhe	Trash. Balaj	3800		

Nr./Dosjes	Data/Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti Kërkes)	Mbiemri (Subjekti Kërkes)	Sip. E Njohur/Mosnjohje M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika	
18	20.09.1996		Malesi e Madhe	Liljana	Muzhani	29000	29000	
5	21.10.1993		Malesi e Madhe	Fadiil	Vuçaj	Negativ		
98	14.02.1995		Puke	Zef	Perndoj	Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative
98	10.01.1996		Puke	Leke	Gjoni	Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative
16	04.02.1994		Fushe - Arrez	Viktor	Qafa	Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative
20	30.09.1996		Puke	Ramadan	Asllani	Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative
65	18.08.1994		Puke	Abedin	Lluka	Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative
48	21.06.1994		Puke	Prend	Gjinaj	Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative
80	06.09.1994		Puke	Preng	Perndoj	Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative
156	29.09.1993		Shkoder	Besnik	Shkrel	Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative
38	22.03.1994		Puke	Qemal	Gradeci	Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative
38	22.03.1994		Puke	Qemal	Kapllani	Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative
460	30.09.1996		Puke	Gezim	Mema	Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative
273	28.06.1996		Shkoder	Anita	Gera	Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative
241	27.06.1996		Shkoder	Tonin	Dajja	Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative
18	15.04.1998		Shkoder	Ismail	Kadija	Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative
22	s'ka		Shkoder	Hil	Xhanaj	Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative
155	05.06.1996		Shkoder	Ndoc	Coba	Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative
288	28.06.1996		Shkoder	Selim	Mema	Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative
284	28.06.1996		Shkoder	But	Smoja	Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative
279	28.06.1996		Shkoder	Trashëgim taret e tij		Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative
278	28.06.1996		Shkoder	Cecile	Kurti	Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative
178	17.06.1996		Shkoder	Mark	Kroqi	Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative
1277	08.09.1994		Shkoder	Hasan	Kaduku	Mbyllje procedimi		Ne dosje nuk ka urdher ushtrim/mosushtim iniciative

(vijon)

INTERVISTA

ALEKSANDËR ZOTO:

Dritëroi, frëngjisht përmes një antologjie poezish

Fatmira Nikolli

Pas disa vitesh pune, miku dhe përkthyes si i veprave të tim eti n? gjuhën frënge, Aleksandër Zoto, ia doli mbanë të botojë një antologji poetike të vyer. Sot, kopjet e para i mora unë në dorë, jo pa emocion. Ishte Dritëroi ai që i gëzohej i pari veprave të tij të përkthyer e botuara dhe ne të tjerëve na shpërndahej si jehonë gazi e gëzimi i tij. Sot, zëri i tij do të kumbonte nëpërmjet fillit telefonik: Zoto, more pedhja Zotos! Ef karisto more djalosh për punën!


Ky shënim i Elona Agollit pak ditë më parë, bëhet shkas për një bisedë me përkthyesin e Dritëroit. Aleksandër Zoto, është përkthyes i njohur i veprave shqipe në gjuhën frënge. Për kontributin e gjithanshëm e të çmuar në përkthimin dhe promovimin e dhjetëra shkrimtarëve dhe veprave të letërsisë shqipe në gjuhën dhe kulturën franceze. Ai mori vite më parë çmimin "Jusuf Vriioni".

Aleksandër Zoto, me origjinë nga Himara ka lindur në Saint Etienne në 1939. Po në atë qytet ka mbaruar studimet universitare. Është specializuar në filologjinë klasike për greqishten e vjetër dhe latinishten në Lion. Që prej vitit 1972 ai filloi të punonte për herë të parë në Universitetin filologjik të Saint-Etienne me cilësinë e lektorit (maitre de conference) të letërsisë frënge të shekullit të shtatëmbëdhjetë. Paralel me këto është marrë me përkthime.

Në intervistën e shkurtër më poshtë ai flet për Agollin dhe raportin e tij me të. - Sa poezi keni përkthyer? S'kam si t'i numëroj: përfshihen në tri vëllime, ky i fundit, i cili, siç përmendet në parathënie, u para-pri nga një tjetër (À fleur de fables, dmth "Tek mbijnë fabulat"), nga i njëjti botues, si dhe një cikël prej 30 teksteve botuar në revistën "Pelegrin" që del në Athinë dhe që drejtohet nga Nase Jani.

- Si i keni përzgjedhur? Sipas shijes sime personale, por edhe duke nuhatur një tingëllim të kënaqshëm në gjuhën frënge, njëfarë parandjenje se do t'ia dal bukur në krye, me gjithë punën që kërkohet.

Përkthyesi: S'pati asnjë udhëzim a këshillë nga ana e tij, më la plotësisht të lirë



- Cilat kanë qenë bisedat që keni bërë me Dritëroin për përzgjedhjen e përkthimit?

S'pati asnjë udhëzim a këshillë nga ana e tij, as shprehje të ndonjë preference. Më la plotësisht të



Dorëshkrimi i Dritëro Agollit

lirë. Ishte puna ime të zgjidhja nga ato poezi ku Dritëroi më duket se është plotësisht Dritëro, se i ng-

jan Dritëroi më se kurrë. Ju thashë, në përgjigjen e parë, se i zgjodha sipas përqimit tim: por pikërisht,

1978, kur Ansambli Folklorik grek vizitonte Shqipërinë e shtëpinë e Enverit

Në korrik 1978, grupi folkloristik grek "Kri-stalis" udhëtoi me autobus drejt Shqipërisë. Gjithë udhëtimi i tyre nga jugu në veri e në kthim shoqërohet nga një ekip shqiptar që e xhiron atë në të gjitha ndalesat e bëra. Sot, kronika në fjalë ruhet në Arkivin Qendror të filmit, si një pikë bashkëpunimi kulturor mes dy vendeve.

Saranda ishte qyteti i parë që i priste, teksa rrugës shiheshin kanali i Butrintit dhe fusha e Vrinës. Pas ndalesës në Butrint te pagëzimet, shkuar në Gjirrokastër ku ansambli dha shfaqje. Ansambli vizitoi muzeun e luftës, dhomën ku lindi Enveri, kalanë e muzeun e armëve.

Një kronikë e kohës që ruhet në AQSHE, përcjell pamje të përgjithshme të



Dropullit, sheshin ku artistët takohen me fshataret dropulite dhe takimin me kryetaren e kooperativës së Grapshit, Krisavgji Zhdallo. Kooperativistët dropullite dhanë shfaqje, grupi i vajzave kërcëu ndërsa gratë kënduan derisa autobusi me pjesëtarët e ansambllit grek ju afrua Fierit, e mandej Durësit ku ata vizituan edhe muzeun me relikte të antik-

titit. Artistët e shtetit fqinj vizituan Shkodrën, uzinën e Tëllave. Ansambllin grek e priste Sulejman Bushati, kryetar i Komitetit Ekzekutiv të K.P. të rrethit në një takim ku ndodhet dhe sekretari i ambasadës së Greqisë Vasile Simandiraqis. Miqtë përshëndetën me këngën shqiptare "Ti më je si një gonxhe". Pas Shkodrës, ansambli

grek mbërrin në Laç, Krujë ku njihet me pazarin, viziton kalanë dhe muzeun kombëtar "Gjergj Kastriot Skënderbeu". Artistët vizitojnë ekspozitën "Shqipëria sot", ekspozitën Etnografike dhe jep koncert në Tiranë. Më pas ansambli grek udhëton me autobus drejt Korçës ku vizitojnë ndërmarrjen e prodhimit të qilimave. Artistët ndjekin procesin e punës së tezgjahisteve. Kronika përfshin Janis Parios duke kënduar këngën shqiptare "Trëndëlinë" çka pritet me duartrokjet. Ansambli grek kalon në pikën turistike të Pogradecit, Volorekë. Turneu i grupit "Kri-stalis" i jep fund shfaqjeve dhe kthehet në Greqi. Kronika shoqërohet me pamjet e operatorit Jovan Kondakci dhe redaktor është Luan Rama.

një nga kriteret e pëlqimit, ishte po përshtypja ime personale se firma ishte thuajse dyfish e tija.

- Si ka qenë raport i juaj ndër vite me poetin?

Kam qenë herët si i shtëpisë së tij, qysh nga qëndrimet e mia të para në Shqipëri.

- Çfarë ka të veçantë kjo antologji?

Dallohet nga larmia tematike, pra nga shumica e teksteve, të marra nga pothuaj gjithë krijimtaria e tij poetike, por edhe nga paraqitja dygjuhëshe, si dhe nga një aparat kritik e historik që e bëjnë këtë antologji një fare botimi reference, pa u mburrur se tepërmi, besoj. Shprehem këtu edhe në emër të botuesit, duke thënë se kjo përmbledhje ka vendin e saj së paku në bibliotekën e secilit universiteti a liceu shqiptar ku mësohet frëngjishtja.

- Keni përkthyer edhe "Njeriu me top" e "Zhurmen e erërave të dikurshme", si ka qenë puna ndër vite me të?

Tamam si puna e përkthimit të poezive. Mirë më vjen, këtu, t'ju kujtoj se kolegu dhe miku im Christian Gut, siguroi suksesin e një romani të tretë, me përkthimin e tij të sosur: "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo", që e dha shtëpia Galimard.

- Çfarë kërkonte ai nga përkthyesi?

Dritëroi na ka lënë, gjithashtu, një seri të ndjeshme përkthimesh, nga Ricos si dhe nga "shekulli i argjendte" rus në veçanti (çështja shtjellohet në fund të librit), dhe mjaftonte të "frëngëroja" unë shkrimet e tij po ashtu, brenda mundësive, si i "shqipëroi" ata poetë me të cilët ka udhëtuar në jetë, sipas titullit të një "kapitulli" të vëllimit "Udhëtoj i menduar". Vetë këto folje shqipërore dhe frëngërore përbëjnë një program a teori të tërë të artit të përkthimit, duke nënkuptuar jo vetëm natyrshmërinë e shprehjes në "gjuhën e mbërritjes", por edhe kalimin nëpërmjet po kësaj gjuhe të asaj që e bën origjinalin... origjinal, që ta them pak si në mënyrën prej shakatari që i pëlqente Dritëroit ta përdorë!

- A i ruani letërkëmbimet me të? Çfarë do të veçtoni?

Jo, s'kemi pasur korrespondencë postare; punët rregulloheshin gojë me gojë në Tiranë, me rastin e qëndrimeve të mia, ose telefonikisht.

VIP

Suplement
Pages

E mërkurë 6 Qershor 2018 GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- I derdhet kafeja, kryeministri holandez e pastron vetë me leckë
- Zv.kryeministrja ndryshon 'look', ngjall dyshime për kandidatë në Shkodër
- Ramush Haradinaj në zyrën e Veliajt, pozon mbi biçikletë
- Plas gallata në parlamentin kosovar, deputeti imiton kreun e Kuvendit, Veseli

Irritohet moderatorja shqiptare: T'ju vijë turp!



Ngrihen temperaturat, Rita Ora vjen më seksi se kurrë



Fatbardha Kadiu:



I ati lavdëroi Ramën, flet deputetja:
Si qëndron e vërteta pas videos

"Njerëzit më të rëndësishëm, ata të cilëve u detyrohem arrijtjet e mia në jetë"

Rrëfëhet deputetja e PD-së: Ja cili është pasioni im pas politikës

I ati lavdëroi Ramën, Fatbardha Kadiu: Si qëndron e vërteta pas videos

"Njerëzit më të rëndësishëm, ata të cilëve u detyrohem arritjet e mia në jetë"

Në zgjedhjet parlamentare të vitit të shkuar, në qytetin bregdetar të Durrësit spikati e vetmja deputete e zgjedhur femër nga Partia Demokratike. Fatbardha Kadiu nuk njihet vetëm si deputete, por gjithashtu edhe si profesore në universitetin "Alfred Moisiu". Por, po të kërkojmë me vëmendje nëpër rrjetet sociale, do të shohim se kjo deputete është shumë pak e njohur dhe tepër e rezervuar për jetën e saj private. Në një intervistë ekskluzive për "VIP Pages" të "Gazeta Shqiptare", ajo ka rrëfyer aspiratat e saj dhe pasionet përtej kornizave të politikës. Gjithashtu, znj. Kadiu u laka së tepërmi para pak kohësh për faktin nëpër media u diskutua se i ati i saj lavdëronte kreun e PS-së, Edi Rama. Por si qëndron e vërteta sipas deputetes së PD-së? Për më tepër, në intervistën e mëposhtme:



Fatbardha Kadiu



Jeni e vetmja deputete e PD për Durrësin. Si u ndjetë kur fituat këtë post?

Ishte një propozim i ardhur nga kryetari i PDSH-së, si pasojë e përfshirjes sime në veprimtarinë e partisë së degës prej vitesh. Ndonëse kontributi im ka qenë kryesisht i ardhur nga sfera akademike, duke u përpjekur të sjell diçka nga mendimi ekonomik në një organizatë politike të një dege qyteti, ku nuk është aspak e lehtë që aktiviteti politik të shtrihet gjerësisht. Siç mund ta dimë, partitë politike në qytetet e tjera veç Tiranës, kryesisht aktivizohen në mobilizime qytetarësh dhe aktivitet propagandistik. Nuk është e thjeshtë të bësh politikë zhvillimi në organizatat e partisë në qytete. Ende sot e mendoj që kjo është një sfida që duhet realizuar. Përveçse deputete, ju jeni edhe profesore në universitet. Cila është arsyeja që ju shtyju të ishit pjesë e politikës?

Rinia, rinia dhe vetëm rinia. Indiferenca e të rinjve ndaj dijes, trishtimi në sytë e tyre për të nesërmen. Deformimi i dijes, transformimi i informacionit si dije. Frika që këta të rinj do të lenë vendin, ashtu siç aktualisht po ndodh.

Cili është pasioni më i madh i tuaj në jetë, shkëputur nga rutina?

Kur thua pasion tinglell në një lloj nuance apo një lloj gatishmërie për të vuajtur për hir të asaj që do, e në këtë aspekt të mirëfilltë të fjalës, "pasion" unë nuk kam asnjë lloj pasioni. Por, besoj që gjërat bëhen me pasion, punët apo qëllimet arrihen me

pasion, në rast të kundërt nuk i arrin dot. Dhe çdo gjë në jetën time e bëj me pasion duke nisur që nga të qenurit prind, bashkëshorte, bijë, motër, mike, profesore e deputete.

A është bashkëshorti juaj suportues në punën që ju bëni? Natyrisht. Bashkëshorti im është shoku im i jetës, është babai i tre fëmijëve të mi, është gjysma e jetës sime. Në këtë kuptim ai është suportues, mbështetës, kritik, por në të njëjtën kohë në momente të caktuara është jo-suportues, jombështetës etj. E rëndësishme është që ashtu siç suportohemi, edhe sfidohemi.

Thuhet se më parë familja juaj ka qenë e majtë dhe është vënë re së vitin që shkoi, babai juaj lavdëroi Edi Ramën. Cilat janë arsyet që ju shtynë të zgjidhni PD?

Gjyshi im, Sulejman Kadiu është një nga patriotët që ngritën flamurin në sheshin "Iliria" në Durrës në datë 26 nëntor 1912, pjesë e Kuvendit në një legjislaturë dhe më pas u burgos nga regjimi nga viti 1945-1950. Në të njëjtën kohë e gjithë familja u internua. Babai im është 85 vjeç dhe ka një karrierë sportive 72-vjeçare si notar. Ka 38 rekorde, medalje ari. Kuvendi i ka akorduar medaljen "Naim Frashëri".



Mban titullin "Nderi i Notit Shqiptar". Me rezultatet e arritura është një ndër 15 sportistët më të mirë në botë për sportin e notit. Në videon me Ramën, im atë shpreh një frazë, që e thotë një njeri, i cili jetën e tij e ka të lidhur me pishinën. Ndoshta madje njerëzit as nuk e kanë kuptuar që biseda është zhvilluar në inaugurimin e pishinës së Durrësit.

Në rininë tuaj, ose ndoshta edhe më parë, çfarë dëshironit të bëheshit?

Në fakt kam dashur të vazhdoj studimet për matematikë dhe e mendoj akoma që mund ta realizoj. Pa dashur të humb elementet e modestisë, kam dashur të bëhem kjo që jam sot dhe jo

vetëm në kuptimin thjeshtë të pozicionit, por në të gjithë kompleksitetin e të qenit një njeri i vetëkompletuar si në karrierë, në marrëdhënie njerëzore, miqësi, familje etj.

A i rrisin fëmijët me frymë politike?

Besoj dhe në fakt çdo ditë përpiqem që fëmijët të mos të kenë lidhje as tangente me politikën, sepse janë në një moshë të vogël dhe duhet të jetojnë fëmijërinë në botën e tyre të bukur e të drejtë. Besoj se çdo njohuri ka kohën e vet dhe fëmijët e mi janë akoma shumë të vegjël të njihen me politikën, por në mënyrë indirekte si çdo prind, unë u ushqej fëmijëve disa vlera të caktuara që ato bëhen dhe baza e zgjedhjeve të tyre në të ardhmen.

Mendoni se është më mirë që ata të vijojnë studimet jashtë, si shumica e fëmijëve të politikaneve, apo këtu? Pse?

Të studiuarit jashtë nga vetë eksperiencia ime personale mund të them që ka aspektet e veta pozitive, ashtu edhe negative. Besoj që më e rëndësishmja është që fëmija të kuptojë që po studion për të fituar dije, për të fituar eksperiencë, që një ditë të jetë i aftë të kontribuojë në shoqëri me norma, vlera dhe njohuri universale.

Ju jeni profesore më parë se politikane. Cila është vlera më e lartë që u mësoni studentëve?

Të qenurit në universitet, asnjë profesor nuk i lejon vetes t'u mësojë studentëve vlera, sepse supozohet që ata janë maxhorenë. Por ka një sërë indikatorësh që pedagogu mundohet t'i tregojë me sjelljet e tij studentit. Për shkak ndoshta të profilit tim në degën e Ekonomiksit, ku gjithçka është teori dhe teoritë janë të shumta, mendohej gjithmonë t'u tregoj studentëve rëndësinë e supozimeve mbi të cilat ngrihen teoritë apo ngjarjet e caktuara, mendohej t'u tregoj që pyetjet

shpeshherë janë më të rëndësishme se vetë përgjigjet dhe në fund jo qëndrimet, por argumentimi i qëndrimeve bëjnë diferencën.

Cila është pika kulmore që mbani mend, ku gjithçka mori kthesë dhe jeni këtu ku jeni?

Unë jam sot këtu në sajë të përmirësimeve të mia, meritave të mia, punës dhe vullnetit tim të përditshëm, luftës që bëj çdo ditë me veten time, ndaj besoj fort që arritja nuk vjen si kthesë e menjëhershme, apo përmes pikave kulmore, por vjen nga përpjekjet e përditshme dhe zgjedhjet e përditshme që bëjnë njeriu në jetën e tij. Por mbi gjithçka dhe për gjithçka kam dhe jam falënderoj Zotin.

Cila është pendesa më e madhe? Pse?

Pendesa të mëdha nuk kam besoj dhe në fakt nuk i ngrë shumë pyetjet: "Po sikur të kisha bërë kështu ose ashtu", thjesht mendoj çfarë të bëj më mirë nesër. Kushëtzohem në të gjithë jetesën time si atë familjare, ashtu edhe atë profesionale të kem sjelljen më të lartë të mundshme.

Cili është personi që ju ka frymëzuar në jetë apo ju ka nxjerrur të ecni përpara?

Nuk mund të them persona që më kanë frymëzuar, por mund të them që një sërë njerëzish kanë pasur ndikim në jetën time. Duke nisur që nga familjarët e mi, mënyra sesi të gjithë bashkë kemi kapërcyer momente tragjike tonat, po ashtu matematicienë dhe ekonomistë si John Nash, William Vickrey, James Mirrlees etj., më kanë frymëzuar disi. Por besoj që tashmë frymëzimin e marr nga Bardha, më njafton të shoh brenda mendjes, unit apo ndërjegjes sime e të gjej frymëzim.

Nëse do të mundeshit të ktheshit mbrapsht në kohë, çfarë do të ndryshonit në jetën tuaj? Gjithçka dhe asgjë.




IRRITOHET MODERATORJA SHQIPTARE: T'JU VIJË TURP!

Ajo është padyshim një nga moderatorët më 'in' të momentit, e cila shpesh e shpreh se gjithë punën të cilën ka bërë deri më sot e ka falë djersës së saj. Për më tepër, kur e shohim aq aktive në rrjetet sociale, Roza Lati nuk ngurron të shprehë atë që mendon pa doreza. Një sjellje e tillë ka ndodhur edhe së fundmi në "Instastory"-n e saj ku moderatorja e "Why Not?" është irrituar me disa persona duke shkruar: "Internet i fëlliqur, që shikueshmërinë e ke nga injoranca dhe papunësi shqiptare. T'ju vijë turp që më vini në diskutim mirësjelljen, armën time më të fortë. Që s'dimi që në institucionet që unë kam punuar në këtë jetë, jam e para që përshëndes e para punonjësit e parë të një televizioni, biznesi apo çfarëdo qoftë!". Mesa duket, dikush e ka vënë në pikëpyetje mirësjelljen apo edukatën e Rozës. Kush të jetë vallë që i ka dedikuar një status kaq të gjatë?



NGRIHEN TEMPERATURAT, RITA ORA VJEN MË SEKSI SE KURRË

